



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 632/1 Prot.

Shkodër, më 05.11.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 60, datë 27.10.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18, 23, 25, 26, 28, neni 54, shkronja “k”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, dokumentacioni bashkëlidhur me shkresën e KB nr.6351 prot datë 29.10.2025 “Për miratim e planit të zhvillimit të turizmit 2025-2030 në territorin administrativ të Bashkisë Vau Dejës”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 60 datë 27.10. 2025

“PËR MIRATIM E PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT 2025-2030, TË BASHKISË VAU DEJËS”.

Në mbështetje ligjin nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika k “Miraton norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interes publik”; Ligji nr 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar me Ligjin Nr 114/2017, datë 18.12.2017; nr 1012/2018, datë 30/2024, datë 04.04.2024. dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I

- 1.Miratimin “Për miratim e plani i zhvillimit të turizmit 2025-2030, të Bashkisë Vau Dejës”:
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”)i ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Ervis Shimaj

SEKRETAR KËSHILLI
Ardian Çelepija

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kunder -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 29.10 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE, ARSIMIT RINISE SPORTIT DHE
ZHVILLIMIT TE TURIZMIT

PROJEKT VENDIM

Nr 01 datë 08.10.2025

**“PËR MIRATIM E PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT 2025-2030, TË BASHKISË
VAU DEJËS”.**

Në mbështetje ligjin nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika k “Miraton norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interes publik”; Ligji nr 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar me Ligjin Nr 114/2017, datë 18.12.2017; nr 1012/2018, datë 30/2024, datë 04.04.2024. dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

VENDOSI

1. Miratimin “Për miratim e plani i zhvillimit të turizmit 2025-2030, të Bashkisë Vau Dejës”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:
Antonia Pjetroj ; Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Turizmit dhe Trashegimis
Kulturore

Miratoi:
Devis Peci : Drejtor/ Drejtoria e Ndiemes Ekonomike, Arsimit Rinise
Sportit dhe Zhvillimit te Turizmit.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni

Konfirmoi Bazën Ligjore:
Çështjeve Gjyqësore

Emilender Pjetroj : Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

**DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE, ARSIMIT RINISE SPORTIT DHE
ZHVILLIMIT TE TURIZMIT**

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËR PERIUDHËN 2025-2030, TË BASHKISË VAU DEJËS”

DREJTUAR : Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin” (i ndryshuar) që inkurajon bashkitë të hartojnë strategji turistike në përputhje me politikat kombëtare. Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (2019–2023) që udhëzon bashkitë që planet e tyre lokale të jenë në përputhje me objektivat kombëtare të turizmit, si dhe Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton kompetencat e bashkive, përfshirë të drejtën për të hartuar dhe miratuar plane zhvillimi lokal, si dhe për të marrë vendime mbi zhvillimin ekonomik lokal, përfshirë turizmin, Bashkia Vau Dejës ka hartuar Planin e Zhvillimi të Turizmit Vendor 2025-2030.

Hartimi i planit siguron një mbështetje të planifikuar të zhvillimit të turizmit me objektiva të qarta strategjike për periudhën 2025-2030 dhe me plane konkrete të ndërhyrjes në drejtim të përmirësimit të ofertës turistike, ndërhyrje infrastrukturore në shërbim të turizmit, përmirësimit të promovimit të burimeve turistike të zonës, duke përmbyllur detyrimet ligjore të Bashkisë.

Në hartimin e këtij Plani, Bashkia është mbështetur nga Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian “VAU DEJES si një Destinacion Turistik”, nëpërmjet ekspertit të përzgjedhur me eksperiencë të gjatë në këtë fushë, i cili ka bashkëpunuar ngushtësisht me zyrën e turizmit në Bashki, si dhe përmes një konsultim të gjërë me aktorë të rëndësishëm që kanë një njohje të thelluar mbi turizmin apo që luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimi e tij.

Hartimi i plani është zhvilluar në një hark kohor prej 9 muaj, i cili kaloi nëpër këto hapa:

1- Studimi i dokumentave strategjike për turizmin dhe kryeja e analizave

Puna për Planin e Zhvillimit të Turizmit filloi me studimin e strategjive dhe ligjeve kombëtare për turizmin, për ta hartuar atë në përputhje me to, si dhe duke e strukturuar sipas kërkesave të nenit nr. 30 të Ligjit 93/2015 “Për Turizmin”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Po ashtu u konsultua edhe Plani i zhvillimit të territorit të Bashkisë Vau Dejës (2017). Procesi vazhdoi me grumbullimin e të dhëna mbi të gjitha potencialet turistike të zonës, ku u analizuan pikat e forta dhe të dobëta dhe mundësitë për tu zhvilluar turizmi bazuar në konceptet dhe parimet e turizmit të qëndrueshëm, si dhe praktika të tjera të suksesshme.

2- Konsultime me aktorë të ndryshëm të tuzimit për mbledhjen e të dhënave

Procesi i hartimit vazhdoi me mbledhjen e të dhënave në terren ku fushat e ndërhyrjes janë përcaktuar pas konsultimeve me rreth 10 vizita në terren ku janë organizuar takime me aktorë të ndryshëm aktivë të turizmit, si ekspertë, biznese, historianë, agjenci turistike, organizata të shoqërisë civile dhe veprimtarë aktivë në fushën e turizmit. 2 seanca konsultimesh janë organizuar edhe me stafin e bashkisë, Keshillin Bashkiak që kontribuan me ide për zhvillimin e turizmit.

3-Konsultimi Publik: Pas përgatitjes së draftit ai kaloi për konsultim publik në takime me komunitetin të organizuara në njësitë administrative në Hajmel dhe Bushat.

4-Metoda me pjesëmarrje: Hartimi i planit ka ndjekur metodën me pjesëmarrje ku të gjitha fushat prioritare të ndërhyrjes kanë qënë produkt i konsultimeve dhe diskutimeve të vazhdueshme me komunitetin dhe aktorët kontribues në zhvillimin e turizmit.

Plani për Zhvillimin e Turizmit në Bashkinë Vau i Dejës (2025-2030) përfaqëson një instrument strategjik që orienton zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në territorin e bashkisë. Plani përkthen vizionin e turizmit në objektiva konkrete dhe masa të zbatueshme; Harmonizon zhvillimin lokal me kuadrin ligjor kombëtar dhe planet hierarkike; Ofron një paketë ndërhyrjesh për zhvillimin e produktit turistik, përmirësimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e klimës së biznesit; Përcakton rolin e Zyrës së Turizmit si qendër koordinuese, në bashkëpunim me aktorët publikë, privatë dhe komunitetin.

Ky plan i miratuar do të shërbejë si bazë për ndërtimin e planeve vjetore, sistemit të menaxhimit të turizmit dhe mobilizimin e financimeve të mundshme, duke orientuar të gjithë aktorët drejt një vizioni të përbashkët për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Vau i Dejës.

Bashkia e Vaut të Dejës ka për detyrë të vazhdojë të ndjekë zhvillimin e turizmit të zonës duke u bazuar tek ky plan, si dhe ta përmirësojë më tej këtë plan nën dritën e zhvillimeve të reja për të siguruar përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të komunitetit dhe kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe mjedisit në Bashkinë tonë.

Konceptoi
Antonio Pjetraj

Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Turizmit dhe Trashegimis Kulturore



**BASHKIA
VAU I DEJËS**

PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

2025-2030



PROJEKTI
VAU I DEJËS SI
DESTINACION TURISTIK

Projekti 'Vau i Dejës si Destinacion Turistik'

Drejtuese e hartimit të planit: **Alida Kondi**

Materiali u punua nga ekspert: **Luan Dervishej**

Ky dokument është prodhuar me asistencën financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe Qendrës për Promovimin e Konkurrueshmërisë dhe nuk reflekton në asnjë rrethanë pozicionin e Bashkimit Evropian.

This document has been produced with the financial assistance of the European Union.

The contents of this document are the sole responsibility of the Municipality of Vau i Dejës and the Centre for Competitiveness Promotion and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union.

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE TË ANALIZËS

1.1 Niveli i zhvillimit të produktturistik, ecuria e zhvillimit dhe roli i aktorëve.....	5
1.2 Aktorët kryesorë në lidhje me turizmin - roli dhe potenciali i tyre.....	8
1.3 Vlerësim i situatës së menaxhimit të turizmit.....	9
1.4 Potenciali dhe roli i turizmit për territorin e Bashkisë Vau i Dejës.....	12
1.5 Parakushtet dhe faktorët e suksesit për zhvillimin e turizmit dhe zbatimin e planit.....	13
1.6 Roli i planit të zhvillimit të turizmit dhe prioritet që duhet të adresojë	15
1.7 Vizioni për turizmin në destinacionin bashkia Vau i Dejes	16

2. PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËR BASHKINË VAU I DEJËS 2025-2030

2.1 Vizioni dhe misioni i zhvillimit të turizmit për Bashkinë Vau i Dejës.....	17
2.2 Objektivat ekonomike dhe sociale	19
2.3 Fushat prioritare të zhvillimit të turizmit.....	19
2.4 Qasja strategjike e bashkisë Vau i Dejës ndaj turizmit	19
2.5 Objektivat për destinacionet dhe produktet turistike të territorit të Bashkisë Vau i Dejës	21
2.5.1 <i>Komani, me liqenin e Komanit dhe Malësite e Cukalit si destinacion për turizmin e natyrës dhe rekreacion ujor përgjatë lugines së Drinit dhe pjesës jugore të Alpeve</i>	21
2.5.2 <i>Lugina e Drinit me liqenin e Vaut të Dejes, oferte e integruar e tureve rekreative kulturore-natyre-ujore.....</i>	23
2.5.3 <i>Bushat - Dioqeza e Sapës, oferte e turizmit kulturor, agroturizmit dhe hoteleve me pishina dhe spa</i>	25
2.6 Objektivat strukturore.....	28

3. PLANI I VEPRIMIT

29

1. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE TË ANALIZËS

◆ 1.1 Niveli i zhvillimit të produktit turistik, ecuria e zhvillimit dhe roli i aktorëve

Vau i Dejës si territor me potenciale turistike ka një larmi gjeografike dhe burimesh turistike që përfshin korridorin lumor të luginës së Drinit me peisazhin malor të gjelbërt, pjesën jugore të Alpeve me njësitë Shllak e Temal, zgjatimin e krahinës me traditë bujqësore dhe kulturore të Zadrimës dhe zotëron objekte të trashëgimisë arkeologjike, historike e fetare si rrënojat e Kalave të Dalmacës, Sardës, Danjës, Sapës, Vigut, kishat e Shën Markut, dioqezës së Sapës, Naraçit, shtëpinë e Ndre Mjedës, traditat kulturore e etnografike etj.

Në raport me tregun turistik Vau i Dejës ndodhet ndërmjet territoreve me burimeve turistike me një fluks në rritje të vizitorëve, vendas dhe ndërkombëtarë.

Këtë pozicionim e kanë konfirmuar dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit dhe Plani Kombëtar Sektorial për Turizmin i Alpeve, ku Territorin e Bashkisë Vau i Dejës nga pikpamja turistike e kanë vlerësuar si një pjesë të korridorit natyror e lumor që lidh bregdetin dhe Shkodrën me Alpet dhe ku pjesa e njësisë administrative të Shllakut e Temalit konsiderohen si pjesë jugore e territorit të Alpeve dhe Komani si një nga portat hyrëse në këtë rajon.

- ✓ *Alpet* – destinacioni kryesor i turizmit të natyrës në Shqipëri për vizitorët ndërkombëtare
- ✓ *Shkodra* – destinacioni kryesor qendër në Veriun e Shqipërisë për turizmin e gërshtetuar urban, të kulturës dhe natyrës dhe qendra kryesore e shërbimeve turistike në rajon.
- ✓ *Zadrima* – një ndër rajonet me traditë për trashëgiminë kulturore dhe traditat bujqësore dhe një ndër atraksionet më të spikatura për agroturizmin në Shqipëri, me ofertën agroturistike të Mrizit të Zanave, me produktet tipike të zonës si vera dhe ullinjtë e varietetit të Kallmetit, historinë kulturore të kishave, kolegjin e Troshanit dhe Fishtë.
- ✓ *Velipoja dhe Shëngjini* si dy qendrat kryesore të turizmit të diellit dhe të rërës në Veriun e Shqipërisë me vizitorë kryesisht nga Kosova, vendas por dhe vizitorë ndërkombëtarë në rritje.
- ✓ *Puka*, një ndër zonat e njohura për tradita historike dhe burime natyrore, tashmë me një qendër qyteti më atraktive e të rehabilituar, me resortin e Përparim Laçit, Birrën Puka dhe itinerare të ecjes në natyrë, me një territor të origjinës historike të mjaft fiseve që përbëjnë një pjesë të popullsisë së sotme të Kosovës, me një akses të përmirësuar rrugor është një destinacion në zbulim e frekuentim në rritje.

Kërkesa turistike për aktivitete dhe produkte turistike të ofruara në zonën e mësipërme të Veriut të Shqipërisë, si turizmi natyror në Alpe, turizmi rural dhe agroturizmi në Alpe dhe Zadrimë, lëvizje dhe turne të kombinuara në atraksione natyrore, kulturore dhe rurale nga makina, në këmbë dhe biçikleta vazhdojnë të rriten si globalisht dhe veçanërisht në Shqipëri dhe në këtë rajon.

Aktivitetet e turizmit kulturor dhe natyror në nivel rajonal për vizitorët që qëndrojnë në Shkodër janë vizita të ndërthurura kulturë dhe natyrë me makinë, shëtitje dhe çiklizëm

– Shiroka, Postriba, Vau i Dejës dhe vizitorët që shkojnë drejt liqenit të Komanit, për të marrë rrugën e tragetit për në Fierzë ose me anije për në lumin Shalë.

Ky pozicionim gjeografik i Vaut të Dejës në raport me flukset turistike në rajon krijon mundësinë për të përfituar nga zgjerimi i produkteve, ofertave, itinerareve apo lëvizjeve të ndryshme të turistëve në njësi të ndryshme territoriale:

- ✓ *Zona e Komanit* si destinacion turistik me shtrirje në të dy anët e maleve të Temalit me malin e Cukalit dhe drejt Pukës.
- ✓ *Zona e Nën-Shkodrës* si zgjatim i paketave ditore turistike kulturore, të çiklizmit
- ✓ *Hotelet në rrugën nacionale* – si zgjatim i ofertës së akomodimit të Shkodrës, me hotele me pishina.
- ✓ *Hajmel-Sapa* si zgjerim i ofertës turistike të Zadrimës
- ✓ *Zona e Vaut të Dejës* – si shtrirje dhe nyje e itinerareve turistike të Komanit, Shkodrës, Zadrimës, Pukës.

Turizmi në territorin e Bashkisë Vau i Dejës si pjesë e korridorit natyror lumor që lidh bregdetin dhe Shkodrën me Alpet po epiqendron aktualisht në luginën e Komanit si një atraksion tërheqës për vizitorët e turizmit natyror ndërkombëtar dhe vendas.

Ky atraksion karakterizohet nga mjedisi dhe peizazhi lumor me natyrën malore dhe të gjelbër të të dy anëve të luginës, me kulmin e peizazhit të lumit Shalë dhe me një hapësirë të bollshme natyrore ujore dhe pyjore për aktivitetin e rekreacionit në natyrë.

Organizimi i shërbimeve kryesore të akomodimit dhe lundrimit, me ofertën e shërbimeve me itinerare për shëtitje në natyrë (dhe të postuara në internet) dhe me shërbimet e disa guidave lokale dhe shëtitjes me varkë kanë krijuar një ofertë bazë për kthimin e Komanit si destinacion vendqëndrimi jo vetëm për një natë në lëvizjen e vizitorëve drejt liqenit të Komanit.

Përveç këtij destinacioni, qendrat rreth të cilave ofrohen disa shërbime turistike dhe janë pika informacioni dhe lëvizjeje për aktivitete përreth janë Vau i Dejës-Mjedë ku ofrohet shërbimi akomodimi dhe ushqimi dhe ka atraksione përreth, hotelet pranë rrugës kombëtare në Bushat ku akomodimi dhe infrastruktura ofrohen për shërbime relaksi si pishina dhe Hajmeli ku zhvillohet Betlehemit të gjallë dhe ka atraksione të trashëgimisë kulturore dhe pika me interes për turizmin rural si feramat, plantacionet e pemëve frutore, punishtet e përpunimit të verës dhe vajit të ullirit dhe një pikë e shërbimeve agroturistike aktualisht jo plotësisht funksionale.

Bazeni ujan i Vaut të Dejës ka një atraktivitet më rajonal dhe është një shtesë e ofertës së Komanit për sa i përket tregut ndërkombëtar.

Atraksionet turistike të trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin kanë një atraktivitet disi të ulët dhe janë më të frekuentuara nga niveli kombëtar dhe rajonal, pasi gatishmëria për treg është e ulët.

Kjo vjen nga mungesat në infrastrukturën turistike dhe interpretimi e shoqëruar me mungesën e shërbimeve turistike për Sardën, Dejën, Kalanë e Dalmacës, ndërsa informacioni i aksesit në atraksione është i paqartë për Dioqezën e Sapës dhe Shtëpinë e Ndre Mjedës si dhe për objektet e tjera fetare me interes për turistët në territor.

Gjithashtu mungojnë guida lokale dhe një ofertë e organizuar e turizmit kulturor nga agjencitë turistike. Në veçanti, trashëgimia historike e cila mund të interpretohet me guida dhe ture në territor, duke u ndalur në vende historike dhe monumente kulturore, nuk është e përfaqësuar në ofertën turistike, ndërkohë që kjo trashëgimi kulturore me interes kombëtar mund të tërheqë interesin e turistit kombëtar të Kosovës dhe të diasporës.

Mjedisi urban i qendrave të banuara në mungesë të hapësirave rekreative dhe shërbimeve mjedisore ende nuk ofron mundësinë për një qëndrim me interes të veçantë për vizitorët që kalojnë apo qëndrojnë një natë në Vaun e Dejës dhe Mjede.

Rekreacioni në pellgjet ujore është i ulët pasi nuk ka molo dhe shërbime të rregulluara të varkave. Në pellgun e Vaut të Dejës nën territorin e bashkisë ka dy plazhe ku vetëm njëri ka një njësi shërbimi, por që të dyja kanë nevojë për një projekt të përshtatshëm infrastrukturë rekreative dhe shërbimi.

Për sa i përket zonës Bushat-Hajmel, integrimi i atraksioneve kulturore dhe bujqësore në treg është i ulët dhe për rrjedhojë edhe aktiviteti turistik është i ulët.

Informacioni mbi aktivitetet e çiklizmit, itineraret është i pazhvilluar.

Atraksionet e trashëgimisë kulturore jomateriale përfaqësohen nga Betlehemi i gjallë. Një organizim i tillë është një interpretim në nivelin historik që i jep vlerë emocionale dhe përvojë turistike një ngjarjeje kulturore dhe një model i avancuar i rolit dhe fuqisë së interpretimit në rritjen e atraktivitetit e një atraksioni turistik dhe zhvillimin e produkti turistik.

Përgjatë rrugës Zadrime-Hajmel-Vau i Dejës mungojnë shërbimet dhe ndalesa për vizitorët ku mund të informohen, të blejnë diçka apo të konsumojnë ushqim e pije në shërbime të përshtatshme për turistët. Qendra e fshatit Hajmel, me pak ndërhyrje infrastrukturore, lehtësim dhe orientim për ofrimin e disa shërbimeve, është pika më e përshtatshme për këtë rol, ndërsa hotelet e Bushatit mund të jenë pika e informacionit për lëvizjen e turistëve në zonë dhe ofrimin e ndonjë shërbimi si bickleta apo guidë lokale.

Pikat e interesit të turizmit rural dhe agroturizmit janë të gatishmërisë së ulët për treg për shkak të mungesës së sinjalistikës-informacionit-paketimit turistik dhe marketingut të itinerareve.

ÇFARË DUHET BËRË?

- ✓ Zhvillimi i turizmit duhet të marrë parasysh destinacionet, atraksionet, itineraret dhe shërbimet. Nga sa u analizua, ka vend për ndërhyrje dhe zhvillim në të gjitha këto dimensione.
- ✓ Zhvillimi i produktit kërkon bashkëpunim në harmoni dhe zinxhir.
- ✓ Destinacioni kërkon aktivitete, gamë shërbimesh, cilësi dhe akses në atraksione. Për disa aktivitete kërkon planifikimin e zonave turistike.
- ✓ Destinacionet e përmendura Komani, Vau i Dejës, Hajmel, Bushat duhet të jenë pikë referimi për organizimin e informacionit dhe shërbimeve.
- ✓ Kjo do të kërkonte disa investime publike urbane që mundësojnë jetën e një mjedisi të përshtatshëm ku ofrohen shërbimet.
- ✓ Kthimi i burimeve në atraksione kërkon një plan të profilit të turizmit, aktivitete të përshtatshme, nevoja për infrastrukturë interpretuese, sinjalizuese ose rekreative dhe shërbime të ngjashme.
- ✓ Itineraret kërkojnë programim tematik, lidhje panoramike rrugore me pikat e interesit parësor dhe dytësor, shërbime në atraksione, pika shërbimi dhe marketing dhe informacion.

◆ 1.2 Aktorët kryesore në lidhje me turizmin
– roli dhe potenciali i tyre

FUNKSIONET NE MENAXHIMIN E TURIZMIT	AKTORET
Menaxhimi i destinacionit	Zyra e turizmit
	Komuniteti i shërbimeve turistike
Menaxhimi i atraksioneve	Zyra e turizmit
	Drejtoria e pyjeve
	Bazeni ujqor
	KESH
	Dioqeza
	Donatoret
Zhvillimi i produktit turistik	Zyra e turizmit
	urbanistika
	pyjet
	KESH
	dioqeza
	bujqesia
	komuniteti
	Bizneset turistike
	Ministria e turizmit
	FSHZH
	donatoret
	Komuniteti i të apasionuarve për ecjet në natyrë, me biciklete, vullnetaret e organizimit të Betlehemit
Infrastruktura	FSHZH
	donatoret
Mbeshtetja e sektorit privat	Zyra e turizmit,
	Zyra e bujqësisë
	donatoret
Marketingun dhe informacioni	Zyra e turizmit
	Bizneset e turizmit
	donatoret
	AKT
	Zyra e turizmit në Bashkinë Shkoder
	Agjensite turistike në Tiranë dhe Shkoder
	Guidat turistike

◆ 1.3 Vlerësim i situatës së menaxhimit të turizmit

KOMPONENTET E MENAXHIMIT TE TURIZMIT	VLERESIM I SITUATËS SË MENAXHIMIT TE TURIZMIT – ÇFARË KA!	VLERËSIM I SITUATËS SË MENAXHIMIT TË TURIZMIT – ÇFARË MUNGON!	KOMENTE
STRUKTURAT E MENAXHIMIT			
Struktura e menaxhimit të turizmit.	Strukture me 2 specialiste 1 specialist turizmi 1 specialist per aktivitetet kulturore. Por stafi ka potencial per te marr persiper detyrat pas ripercaktimeve dhe udhezimeve te planit.	Praktike e pakonsoliduar si ne profil, rol,mbulim pergjegjesish.	Mund te kete nevojë per sqarime ne interpretimin e ligjit brenda strukturave te bashkise mbi rolet ne zhvillimin e turizmit perfshire dhe rolin e zyres se turizmit. Mungesa e nje kornize menaxhuese te aspekteve te ekonomise vendore ndikon ne kete rol te limituar ne praktike.
Struktura për zhvillimin ekonomik lokal.		Nuk ka, perfshire dhe pjesen e munguar te pergjegjesive te organizimit te tregjeve dhe panairove vendore dhe marketingun territorial.	
Strukturë per menaxhimin e integruar të mjedisit.	Ka drejtori pyjesh.	mjedisi akoma nuk eshte i strukturuar nen nje menaxhim te integruar per tu mbuluar me funksionet e tjera te nevojshme te menaxhimit mjedisor dhe infrastruktures perkatese.	
PLANIFIKIMI			
Planifikimi i turizmit në perputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.	Ka pasur nje draft plan te brendshme te zyres se turizmit i cili duke marre parasysh pergjegjsite e kufizuara dhe mungesen e burimeve financiare eshte limituar ne propozimet per masat me imediate.		

Planifikimi i zonave turistike dhe pikave turistike – plazhe, në mjediset natyrore, trashëgimi kulturore.	Ka nje plan te mbareshtimit te pyjeve, ku eshte planifikuar hapesira per perdorim e pyjeve per funksione sociale.	Nuk ka plazhe te percaktuara publikisht. Nuk ka nje proces planifikimi te udhehequr nga struktura e turizmit per percaktimin e hapesirave rekreative dhe infrastruktures perkatese. Eshte e nevojshme planifikimi i turizmit per te percaktuar nevojat per infrastrukturen dhe perdorimin turistik.	Mund te kete nevojë per sqarime ne interpretimin e ligjit brenda strukturave te bashkise.
Planifikimi i infrastrukturës turistike	Me teper projekte te donatoreve. Ka nje projekt te porositur nga KESH per mundesi investimesh ne kuader te pergjegjesise sociale, ku jane parashikuar infrastrukture molesh turistike, infrastrukture interpretative, infrastrukture rekreacioni, investime per muze dhe rehabilitime te mjedisit me nje vlere totale rreth 7 milion Euro.	Nuk ka projekte qe jane financuar nga bashkia ndonese jane pjese e planit te pergjithshem vendor dhe prioriteve strategjike. Verehet se kjo infrastrukture sidomos ajo e shtigjeve te markuara dhe informacioni perkates nuk transferohet qartesisht prane bashkise. Projekti i KESH nuk ka ndonje planifikim konkret per venien ne zbatim.	Mund te kete nevojë per sqarime ne interpretimin e ligjit brenda strukturave te bashkise.
Përcaktimi i burimeve turistike, inventarizmi dhe kontrolli, ruajtja dhe menaxhimi i tyre	Dorezohet inventar ne minsitri per cdo vit	Inventari nuk permbledh te gjithë gaten e burimeve dhe nuk ka analize mbi gjendjen e burimeve edhe kthimin e tyre ne produkt. Nuk ka projekte dhe procese per ruajtjen e tyre.	Mund te kete nevojë per sqarime ne interpretimin e ligjit brenda strukturave te bashkise Mungesa e udhezimeve
ZHVILLIMI I PRODUKTIT			
Zhvillimi i produktit turistik	Projektet te donatoreve kryesisht per sinjalistiken turistike, itinerare si psh ai i Veres, itinerare dhe markim shtigjesh ne natyre.	Verehet se kjo infrastrukture dhe informacioni perkates nuk transferohet qartesisht prane bashkise.	

Zhvillimi i aktiviteteve të turizmit kulturor dhe i panairove.		Qendra kulturore jashte funksioni. Mungon organizimi i panairove dhe akoma nuk shfrytezohen mundesite e bashkepunimeve me komunitetin (p.sh. rasti i organizmit te Betlehemit te gjalle ne Hajmel).	
bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre.	Ka disa bashkërendime por jo sistematike.	Bashkërendimet nuk mbulojnë gjithë gamen dhe aktoret.	Nuk ka udhëzime. Mund të ketë nevojë për sqarime në interpretimin e ligjit brenda strukturave të bashkisë.
KUJDESI PER VIZITORËT			
përkujdesja dhe kontrolli për kushtet e mjedisit të sigurt për vizitorët.	Ka disa bashkërendime.	Bashkërendimet janë jo sistematike, që nuk mbulojnë gjithë gamen dhe aktoret.	
MBËSHTETJA E BIZNESIT			
mbështetje për bizneset dhe burimet njerezore.	Projekte të donatoreve	Nuk ka projekte specifike brenda bashkisë për mbështetje.	Mungesa e strukture
INFORMACIONI PER VIZITORET DHE MARKETINGU			
informacioni dhe marketingu për vizitorët dhe bizneset	Projekte të donatoreve Eshtë publikuar një broshurë	Nuk ka zyrë informacioni Nuk ka faqe interneti	
BURIMET E FINANCIMIT			
Mbledhja e takses së fjetjes në hotel		Raportimi nga bashkia tregon një nivel mjaft të ulët.	Mbetet prioritet pasi një pjesë e shpenzimeve të mundshme për zyrë informacioni apo material promocional për turistë mund të ishin mbuluar nga kjo takse mbi turistët.

◆ 1.4 Potenciali dhe roli i turizmit për territorin e Bashkisë Vau i Dejës

Nëse vlerësojmë stadin dhe nivelet e zhvillimit të turizmit, mund të themi se lugina e Komanit po integrohet me gravitet në tregun turistik, tërheqja e turistëve drejt këtij poli ka krijuar një kërkesë për shërbime turistike, ndonëse të kufizuara , përgjatë rrugës në Bushat e Vaut Dejes. Duke marrë parasysh tendencat dhe kërkesat e tregut në nivel global, kombëtar dhe rajonal si dhe në territorin e Vaut të Dejës si pjesë përbërëse e këtyre flukseve, kërkesa turistike do të vijë në rritje ndërkohë që ne kemi potencial të pashfrytëzuar dhe shërbime të kufizuara.

Mundësi ekonomike që mund të krijohen nga zhvillimi i turizmit në njësitë administrative të Bashkisë Vau i Dejës	
Në zonën malore rreth Komanit	Shtimi i bujtinave, integrimi i familjes në shërbime, transporti, guida, ofrimi i produkteve.
Në zonën e Vaut të Dejës	Punësimi i të rinjve si guidë, transport, shërbime si bar restorant, shitje me pakicë.
Në zonën Hajmel-Bushat	Punësimi i të rinjve si guidë, transport, shitje të produkteve vendase, shërbime agroturizmi, bare dhe restorantesh.

ROLI I BASHKISË NË RAPORT ME DESTINACIONIN

Zhvillimi në fazën aktuale ka ardhur nga përgjigja e sipërmarrjes turistike ndaj kërkesës turistike në fakt në një zonë të marginalizuar dhe të shpopulluar si Komani.

Kjo nismë aktualisht po mbulon jo vetëm shërbimin dhe zhvillimin e produktit por gjithsesi nuk mund të zëvendësojë shërbimet dhe rolin publik në destinacion.

Iniciativa private, qoftë edhe në mungesë të përvojës, burimeve dhe mbështetjes, shfaq një frymë sipërmarrëse të admirueshme, ndërsa vlerësimet pozitive të turistëve në platformat e akomodimit online tregojnë se është e adaptueshme për të mësuar dhe përmirësuar në nivele të larta, pa mohuar faktin që niveli familjar i sipërmarrjes së bujtinave integron aftësi të ndryshme brenda familjes, si në nivel gjinor ashtu edhe në nivel brezash.

Kjo fazë e zhvillimit të turizmit në territor ku një destinacion po zhvillohet nga sipërmarrja private tashmë përballet me sfidat e qëndrueshmërisë si trafiku, flukset dhe përplasjet e segmenteve të të ndryshme të tregut si ai masiv me atë të natyrës, cilësia mjedisit që përfshin cilësinë e peizazhit natyror dhe të ndërtuar, menaxhimi i ndotjes, përfshirë ato të zhurmave.

Në zonat ku atraktiviteti është më i ulët, si rezultat i atraktivitetit të ulët të mjedisit urban, moszhvillimit të infrastrukturës së aksesit dhe aktiviteteve rekreative, mungesa e infrastrukturës turistike në atrakcione, në mungesë të zhvillimit të paketave, itinerareve dhe promovimit publik të destinacionit, tani kërkon angazhim publik dhe vëmendje ndaj nevojave për menaxhimin turistik të destinacionit.

◆ 1.5 Parakushtet dhe faktorët e suksesit për zhvillimin e turizmit dhe zbatimin e planit

Për të arritur këtë janë të nevojshme masa ndërhyrje që përfshijnë kategorinë e investimeve dhe angazhimeve financiare, si në infrastrukturën turistike, mjedisin, aksesin dhe infrastrukturën publike, por edhe ato masa të buta që kanë të bëjnë me organizimin dhe koordinimin, klimën e biznesit dhe rritjen të kapaciteteve të tij, marketing, informim dhe kujdes për të gjithë komponentët e turizmit, biznesit, mjedisit, infrastrukturën.

Ajo që u analizua gjatë procesit të hartimit të planit është se megjithëse këto masa janë përfshirë në një sërë planesh, niveli i zbatimit ka mbetur i ulët.

Nga këto gjetje dhe ky reflektim, puna gjatë analizës për hartimit e planit të u përqendrua me interes të veçantë në gjetjen e shkaqeve dhe zgjidhjeve që bëjnë të mundur realizimin e një plani të tillë si:

- *Analiza e sistemit të menaxhimit të turizmit,*
- *qartësimi i përgjegjësi dhe kapaciteteve strukturore të nevojshme për menaxhimin turizmit,*
- *bashkëpunimet dhe ndërveprimet e brendshme dhe të jashtme të strukturave të bashkisë,*
- *identifikimi i aktorëve si nga institucionet e tjera, shoqëria civile dhe komunitetit që mund të bashkëpunojnë, të angazhohen dhe të alokojnë burime që bëjnë të mundur zbatimin e masave në një plan zhvillimi.*

Gjetja e prioriteteve në ato pika të zinxhirit të vlerës, destinacionit apo produktit turistik që bëjnë të mundur përmirësimin dhe zhvillimin e ofertës turistike dhe marketingut ishin disa prioritete që u trajtuan si rezultat i vlerësimit strategjik të fizibilitetit të planeve.

Gjithashtu, konstatohet se faktorët e mësipërm janë ndër shkaqet dhe zgjidhjet për përmirësimin e zbatimit të planeve të zhvillimit.

Duke përmbledhur detyrat e pushtetit vendor në menaxhimin e destinacionit nga të gjitha pjesët e analizuara të legjislacionit, mund të përmbledhim rolin e pushtetit vendor:

PLANIFIKIMI I TURIZMIT

1. Planifikimi i turizmit në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Planifikimi i zonave turistike dhe pikave turistike – plazhe, në mjedise natyrore, trashëgimi kulturore.
3. Planifikimi i infrastrukturave turistike.
4. Përcaktimi i burimeve turistike, inventarizimi dhe kontrolli, ruajtja dhe administrimi i tyre.

ZHVILLIM I PRODUKTIT

5. Zhvillimi i produktit turistik.

MENAXHIMI I DESTINACIONIT NË BASHKËPUNIM ME AKTORËT

6. Bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, veprimtarive që lidhen me turizmin brenda territorit të tyre.

SHËRBYM DHE KUJDES PËR VIZITORËT, BIZNESET DHE MJEDISIN TURISTIK

7. Kujdesin dhe kontrollin e kushteve të mjedisit të sigurt për vizitorët,
8. mbështetje për bizneset dhe burimet njerëzore.

MARKETINGU I DESTINACIONIT

9. Informacion dhe marketing për vizitorët dhe bizneset.

Siç shihet, roli i një strukture të menaxhimit të turizmit në nivel vendor duhet të mbulojë udhëheqjen dhe menaxhimin e të gjitha aspekteve të mësipërme.

Ekziston një nevojë e qartë për një koordinim të brendshëm me strukturat përgjegjëse të pyjeve, urbanistikës, shërbimeve publike, shëndetit parësor, zhvillimit rural, kulturës financave, koordinim me strukturat e tjera publike përgjegjëse për burimet natyrore, trashëgiminë, kulturore, higjienën, sigurinë, mjedisin, transporti, institucionet e turizmit, aktorët e sektorit privat të turizmit dhe vizitorët.

Nga analiza e kornizës udhëzuese për bashkitë në lidhje me menaxhimin e turizmit në zbatim të këtyre detyrave ligjore, rezulton se niveli i orientimit për zbatimin e këtyre detyrave është shumë i ulët dhe paraprakisht mirëkuptojmë se niveli i menaxhimit të turizmit në destinacionet lokale varet nga asistenca teknike që projektet e donatorëve dhe organizatat e shoqërisë civile mund të kenë dhe mund të japin për menaxhimin e turizmit në nivel lokal, si dhe varet nga përvoja dhe iniciativa e krijuar në nivel strukture, praktikash dhe kapacitetesh njerëzore në një bashki të caktuar.

Këto nevoja u konfirmuan edhe në Bashkinë e Vaut të Dejës ku, megjithëse kemi një sektor të vogël turistik, përvoja, përgjegjësitë dhe kapacitetet për të kryer rolin e menaxhimit të destinacionit turistik kanë nevojë për një orientim të qartë dhe vizion dhe mbështetje për të ndërtuar kornizë e plotë të menaxhimit dhe të zbatimit.

Prioritizimi i masave për veprimet e planit kur burimi i financimit për investimet në infrastrukturën paraprake nuk është i garantuar, do të duhet të ndjekë një sekuençë pune ku masat e buta që lidhen me ngritjen e kapaciteteve dhe organizatave ndihmojnë për mobilizimin e masave që kanë nevojë për ndërhyrje dhe investime infrastrukturore:

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit.
- ✓ Ndarjen e buxhetit, duke përfshirë aktivitetet e festave, panairit, informacionin.
- ✓ Identifikimi i atyre masave për planifikim apo udhëzime planifikimi që kanë penguar zhvillimin e produktit, infrastrukturën turistike.
- ✓ Zhvillimi i produkteve që varen tek bashkëpunimi i aktorëve, aktivitetet promovuese apo infrastrukturës së lehtë sinjalizuese dhe informative.
- ✓ Ndërtimi i proceseve bashkëpunuese dhe koordinuese.
- ✓ Aksesin në atraksione duke organizuar një plan vizitueshmërie dhe promovimi i tyre.
- ✓ Për investimet, realizimi i të gjithë procesit për krijimin e projekt-fishave të qarta dhe një plani promovues.
- ✓ Duhet ndërtuar aspekti rregullues i planit të plazheve, kalatave dhe itinerareve.
- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e hapësirës në Qendrën Hajmel për shërbime të përhershme dhe të përkohshme për vizitorët dhe panairin.
- ✓ Ndriçimi për shëtitoren e Qafës së Gurit.

Për vitin 2025

- ✓ Ndërtimi i kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit duke praktikuar aspekte të bashkëpunimit, menaxhimit të informacionit, koordinimit gjatë sezonit, aspekteve të planifikimit.
- ✓ Shpërndarja e informacionit dhe koordinimi i informacionit gjatë sezonit.
- ✓ Organizimi i panairit përgjatë Betlehemit.

- ✓ Planifikimi i aktiviteteve
- ✓ Ndarja e buxhetit, duke përfshirë aktivitetet e pushimeve, panaiet, informacionin.
- ✓ Promovimi i projekteve të investimeve.
- ✓ Plani i aktiviteteve
- ✓ Plani investimeve
- ✓ Promovim
- ✓ Marketingu

◆ 1.6 Roli i planit të zhvillimit të turizmit dhe prioritet që duhet të adresojë

Plani i zhvillimit të turizmit për t'i shërbyer objektivave duhet të mbulojë konceptimin dhe vizionin strategjik si për destinacionin në tërësi ashtu edhe për destinacionet e veçanta dhe të trajtojë të gjithë grupin e detyrave të veçanta të planit turistik në nivel destinacioni lokal me zhvillimin e produktit mjedisin, infrastrukturën, burimet turistike, klimën e biznesit, menaxhimin dhe të kemi një paketë masash konkrete me përgjegjësi. Ai duhet të mbështetet dhe të jetë në hamonizim me të gjithë parashikimet ligjore dhe të planeve hierarkike.

Siç u diskutua më lart, planifikimi dhe menaxhimi i turizmit në nivel destinacioni ka nevojë për bashkëpunimin dhe koordinimin e aktorëve si brenda bashkisë ashtu edhe jashtë saj, institucioneve të tjera publike, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

Një plan zhvillimi orienton të gjithë palët e interesuara të punojnë drejt një vizioni dhe drejtimi strategjik të përbashkët. Prandaj, përmbajtja dhe forma e planit duhet të jetë e tillë që të parashikojë rolin e aktorëve dhe të jetë orientues për të gjithë spektrin e tyre.

ROLI PËR AKTORËT

- ✓ Realizon qartësinë e vizionit dhe objektivave.
- ✓ Krijon bazën mbi të cilën duhet të zbatohen ndërhyrjet në lidhje me turizmin në territor.
- ✓ Udhëzues për të gjithë aktorët për vizionin, konceptet, prioritetet dhe mënyrën e punës.
- ✓ Filozofia e planit bazohet në menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit, me zyrën e turizmit si qendër udhëheqëse në bashkëpunim me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm.
- ✓ Plani i turizmit duhet të shërbejë si plan strategjik pune për zyrën e turizmit, por edhe si udhëzues për ndërtimin e sistemit të menaxhimit dhe ndërtimin e planeve vjetore.
- ✓ Qartësia e aktorëve të angazhuar.
- ✓ Qartësi për mundësitë e financimit dhe qartësi për financuesit e mundshëm.

◆ 1.7 Vizioni për turizmin në destinacionin Bashkia Vau i Dejës

Duke marrë parasysh legjislacionin dhe praktikat ndërkombëtare, vizioni i turizmit të qëndrueshëm duhet të udhëhiqet nga proceset vendimmarrëse dhe menaxhuese.

Interesi publik lokal i turizmit për territorin e Bashkisë Vau i Dejës është se:

- ✓ Turizmi mund të jetë forca kryesore ekonomike në bashkitë me shpopullim të lartë si Shllaku dhe Komani
- ✓ Turizmi mund të rrisë ndikimin në aktivitetin ekonomik në qendrat e banuara të Mjedës dhe Vaut të Dejës dhe në radhë të parë mund të ndikojë në rritjen e cilësisë së jetës si nxitës për përmirësimin e infrastrukturës rekreative dhe mjedisit urban.
- ✓ Turizmi mund të rrisë ndikimin në efektet zinxhir të promovimit të identitetit gjeografik të produkteve bujqësore dhe të rrisë shitjet drejtpërdrejt, në panairë dhe në mënyrë indirekte.
- ✓ Turizmi mund të ndikojë në rritjen e aktiviteteve kulturore dhe në forcimin e identitetit kulturor dhe historik të zonës
- ✓ Mbi të gjitha, ruajtja e cilësisë së mjedisit, e cila është arsyeja kryesore e ardhjes së vizitorëve, është një objektiv i detyrueshëm dhe i panegociueshëm për destinacionin turistik.

Plani i zhvillimit të turizmit
për Bashkinë “Vau i Dejës”
2025-2030

2. PLANI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËR BASHKINË VAU I DEJËS 2025-2030

◆ 2.1 Vizioni dhe misioni i zhvillimit të turizmit për Bashkinë Vau i Dejës

Turizmi në Bashkinë e Vaut të Dejës zhvillohet si një aktivitet ekonomik kyç me efekt zinxhir në mirëqenien ekonomike dhe lidhjen me promovimin e identitetit gjeografik të produkteve të zonës dhe shitjen e tyre, cilësinë e jetës shoqërore. me rritjen e mundësive për rekreacion, në uljen e shpopullimit në zonat malore, ruajtjen e trashëgimisë kulturore të banorëve të zonës, ruajtjen dhe integrimin e vlerave të natyrës në mirëqenien e banorëve.

Turizmi në Bashkinë e Vaut të Dejës zhvillohet bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke balancuar interesat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Zhvillimi i turizmit bazohet në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve turistike në të gjitha njësitë administrative si:

- ✓ koridori lumor i luginës së Drinit me peizazhin e gjelbër malor;
- ✓ pjesa jugore e Alpeve me njësitë Shllak dhe Temal;
- ✓ trashëgiminë kulturore dhe rurale të zonës së Alpeve Jugore;
- ✓ trashëgiminë kulturore të luginës së Drinit me trashëgimi arkeologjike, historike dhe fetare si rrënojat e kështjellave dalmate, Sardës, Danjes, kishat e Shën Markut, kishat e Shën Markut, Naracit;
- ✓ trashëgiminë kulturore të krahinës me traditat bujqësore dhe kulturore të Zadrimës dhe objektet e trashëgimisë arkeologjike, historike dhe fetare si rrënojat e Kështjellave të Sapës, Vigut, dioqeza e Sapës, shtëpia e Ndre Mjedës, etnografia e veshjeve popullore dhe traditave të thurjes artizanale të pëlhurave dhe mëndafshit;
- ✓ trashëgiminë historike të zonës së Bushatit, nga rrënojat arkeologjike të Basanias, vendndodhja e pallateve të Bushatllinjve.

Turizmi bazohet në zhvillimin e një oferte të integruar të produkteve turistike të turizmit natyror, kulturor, rural, rekreacionit lumor, si pjesë integrale e ofertës rajonale të Alpeve Shqiptare dhe zonës së Veriut ndërmjet Shkodrës, Lezhës dhe Pukës.

Bashkia Vau i Dejës si territor konsolidohet si një destinacion për turizmin e natyrës dhe rekreacionin ujorë përgjatë luginës së Drinit, me qendër destinacionin e Komanit dhe Vaut të Dejës, si dhe duke u bërë pjesë përbërëse e ofertës turistike rajonale Shkodër-Pukë-Zadrimë-Lezhë, me një profil turnesh tematike të spikatura dhe të kombinuara trashëgimi kulturore-natyrë-mjedis rural, të organizuar dhe individuale, me makinë, biçikletë, shëtitje në natyrë-shëtitje, duke synuar turistët ndërkombëtarë dhe vendas të interesuar për natyrën dhe turizmin rural, turistët ndërkombëtarë, ato të diasporës, kombëtare dhe rajonale të interesuara për turizmin kulturor dhe rural dhe aktivitetet kombëtare e rajonale për rekreacion lumor.

◆ 2.2 Objektivat ekonomike dhe sociale

Turizmi do të bëhet forca kryesore ekonomike në njësitë me shpopullim të lartë si Shllaku dhe Komani.

Turizmi do të rrisë ndikimin në aktivitetin ekonomik në qendrat e banuara të Mjedës dhe Vaut të Dejës dhe në radhë të parë mund të ndikojë në rritjen e cilësisë së jetës si një stimul për përmirësimin e infrastrukturës rekreative dhe mjedisit urban.

Turizmi do të rrisë ndikimin në efektet zinxhir të promovimit të identitetit gjeografik të produkteve bujqësore dhe do të rrisë shitjet drejtpërdrejt, në panaire dhe në mënyrë indirekte.

Turizmi do të ndikojë në rritjen e aktiviteteve kulturore dhe në forcimin e identitetit kulturor dhe historik të zonës.

Me zbatimin integral të masave të planifikuara në planin e zhvillimit të turizmit, mund të llogaritet se kapaciteti i ofruesve të shërbimeve do të rritet në 5 vitet e ardhshme me rreth 70 biznese dhe aktivitete të lira të shtrira në të gjitha njësitë administrative të bashkisë. me një potencial rreth 200 të punësuar drejtpërdrejt, ndërkohë që efekti zinxhir i lidhjes së shërbimeve të tjera dhe ofrimit të produkteve ushqimore nga fermat mund të prekë rreth 150 familje apo shërbime të tjera në territor).

Mbi të gjitha, ruajtja e cilësisë së mjedisit, e cila është arsyeja kryesore e ardhjes së vizitorëve, është një objektiv i detyrueshëm dhe i panegociueshëm për destinacionin turistik.

◆ 2.3 Fushat prioritare të zhvillimit të turizmit

1. Menaxhim i territorit si destinacion turistik
2. Zhvillim destinacionesh – Koman, Vau i Dejës, Bushat-Hajmel
3. Zhvillim i produkteve kryesore turistike
 - 3.1 *Zhvillimi i produkteve kryesore turistike*
 - 3.2 *Zhvillimi i infrastruktures turistike*
 - 3.3 *Zhvillimi i atraksioneve turistike dhe ambientit turistik*
 - 3.4 *Zhvillimi i infrastrukturës*
4. Mbështetje e sektorit privat
5. Marketing dhe informacion turistik

◆ 2.4 Qasja strategjike e bashkisë Vau i Dejës ndaj turizmit

Duke marrë parasysh këto interesa dhe mundësinë e ndikimit të turizmit në territor, ky plan turistik sjell nevojën e një prioritizimi dhe lidhjes më të madhe të fushave të aktivitetit të shërbimeve të bashkisë, ku:

1. Fusha e zhvillimit ekonomik lokal bëhet prioritare, ku turizmi bashkëpunon dhe ka një efekt zinxhir me zhvillimin rural, bujqësinë dhe marketingun e territorit.

2. Si rrjedhojë, aktorë specifikë në fushën e zhvillimit ekonomik si bizneset dhe vizitorët, aktualë dhe potencialë, marrin prioritet dhe kanë nevojë për shërbime specifike dhe, rrjedhimisht, struktura të dedikuara për këto shërbime.
3. Ndikimi i turizmit në mirëqenien dhe ndërruesia e tij me mjedisin urban, promovimi i trashëgimisë kulturore dhe mjedisi kërkon një prioritet të turizmit në:
 - ✓ *Investimet dhe masat e ndërhyrjeve infrastrukturore, masat e shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit*
 - ✓ *Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe ndërtimi i një programi interpretimi të vlerave të trashëgimisë kulturore duke mobilizuar ata aktorë që kanë njohuri dhe motivim për promovimin e këtyre vlerave, por edhe duke trajnuar guida turistike vendase.*
 - ✓ *Koordinimi në ndërtimin e infrastrukturës së aksesit dhe sinjalistikës interpretuese.*
4. Me gjithë këto ndërveprime, qasja e menaxhimit që bën të mundur këto prioritate kërkon një metodologji pune të orientuar nga planifikimi i turizmit, bashkëpunimi i aktorëve dhe kompetencat profesionale në planifikim, në njohjen e turizmit, menaxhimin e bashkëpunimit i cili duhet të bazohet në struktura profesionale të dedikuara për zhvillimin ekonomik dhe turizmin.
5. Zbatimi i masave për zhvillimin e turizmit bazuar në qasjen e mësipërme të menaxhimit kërkon një kombinim të tre kategorive të masave mbështetëse:
 - ✓ *Një buxhet i dedikuar i strukturës turistike për zhvillimin e produktit turistik, marketingun, informacionin turistik dhe organizimin e aktiviteteve.*
 - ✓ *Një planifikim të masave të investimeve infrastrukturore që lidhen dhe kanë ndikim në turizmin.*
 - ✓ *Planifikimi i masave të buta që përfshijnë asistencë teknike për rritjen e kapaciteteve të bashkisë, kapaciteteve të biznesit dhe kapaciteteve bashkëpunuese të aktorëve.*
6. Burimet e buxhetit: bashkëpunimi dhe sinergjia me aktorët bazuar në planifikimin e mirë, hartimin e projektit.
 - ✓ *Për buxhetin e zyrës së turizmit: tarifa e fjetjes në hotel duhet të mbulojë një pjesë të shpenzimeve.*
 - ✓ *Për zhvillimin e produktit turistik: sinergji me aktorët, projektet e donatorëve,*
 - ✓ *Për aktivitetet: bashkëpunim me aktorët.*
 - ✓ *Investimet në infrastrukturë: buxheti i bashkisë, bashkëpunimi me KESH, FSHZH, aktorë të tjerë*
 - ✓ *Për masat e buta: projektet e donatorëve.*
7. Prioriteti i masave ndjek logjikën e efektivitetit: nevoja për ndërhyrje në zinxhirin e produkteve turistike, ndikimi në efektin zinxhir, efienca në gjetjen e burimeve të financimit, ekuilibri territorial.

◆ 2.5 Objektivat për destinacionet dhe produktet turistike të territorit të Bashkisë Vau i Dejës

2.5.1 Komani, me liqenin e Komanit dhe Malësitë e Cukalit si destinacion për turizmin e natyrës dhe rekreacion ujq përjqatë lugines së Drinit dhe pjesës jugore të Alpeve

Destinacione:

Koman

Malësitë e Cukalit

Burimet turistike: Liqeni i Komanit dhe peizazhi ujq e malor, Malësia e Cukalit dhe Komanit, peizazhi malor dhe rural me mundësi rekreacioni si ecja në natyrë, shijimi i peizazhit, biodiversiteti.

Destinacioni për shërbime dhe akomodim: Komani

Pozicionimi në treg si destinacion: Komani si destinacion për netqëndrime në një peizazh liqenor dhe malor, me një shumëllojshmëri aktiviteteesh ecjeje në Alpe (zona e Temalit dhe Shllakut), vizita me varkë dhe kanoe në liqenin e Vaut të Dejës dhe Komanit dhe turne të kombinuara të vizitave në vendet e trashëgimisë kulturore si kështjellat e Dalmacës dhe Sardës. Oferta turistike është pjesë përbërëse e Alpeve për turizmin natyror dhe rural.

Profili i turizmit: Turizëm natyror dhe kulturor miqësor ndaj mjedisit, me prioritet në dimensionin ekoturizmit. Në përputhje me planin kombëtar të Alpeve.

Tregu i synuar: vizitorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë të turizmit natyror, turizmit rural që janë miqësorë me mjedisin (kategoritë e turistëve të interesuar për natyrën, ekoturistët, turistë aventurë, turistë familjarë që kërkojnë rekreacion të butë dhe paqe në natyrë).

Destinacionet e marketingut të ofertave turistike: Shkodër, tregu kombëtar, Lezhë, Tiranë.

Oferta turistike

Komani është një destinacion për fjetje për turistët, me shërbime akomodimi, ushqim, transport, guidë, informacion turistik, shërbime bazë dhe mundësi për të kaluar kohën e lirë në lëvizje pranë peizazhit liqenor.

Ka oferta të gatshme për xhiro dhe itinerare për shëtitje dhe soditjen e peizazhit të thurur me sfond ujq, pyjq, lumor.

Ka oferta të gatshme në treg për ture dhe itinerare shëtitjesh në natyrë në zonën e Komanit, Shllakut dhe Temalit, si me guidë lokale ashtu edhe me vetë-guidë, ku komuniteti është i integruar në ofrimin e shërbimeve. Itineraret bazohen në një infrastrukturë, tabela të shënuara në terren dhe një hartë të mirëmbajtur.

Ka oferta për aktivitete rekreative ujqore si varka, kano, të ofruara nga bizneset e zonës dhe që funksionojnë sipas standardeve.

Ka turne me gërshetim të prezantimit të vlerave kulturore, historike dhe natyrore, si vizita në kalatë e Dalmacës dhe Sardës, të drejtura nga guidat lokale.

Shërbimet lokale të akomodimit dhe ushqimit ofrohen në përputhje me standardet bazë, me një frymë lokale mikpritjeje dhe produkte vendore me një gamë që mbulon hotelet, bujtinat, kampingjet për autohome.

Hyrja në Koman realizohet nëpërmjet rrugës së rehabilituar Vau Dejës-Koman dhe lëvizjes me varka që operojnë me orar të rregullt si nga drejtimi i Fierzës ashtu edhe nga drejtimi i Vaut të Dejës.

Peizazhi ruhet nga ndërhyrjet dhe mjedisi është i pastër.

Informacioni turistik është përditësuar dhe disponohet gjatë sezonit në Koman, online nga faqja e turizmit të bashkisë si dhe në zyrat e informacionit turistik në Shkodër, Lezhë apo Tiranë.

Objektivat sasiorë për turizmin në destinacion: dyfishimi i numrit të netqëndrimeve për 5 vitet e ardhshme, zgjatja e sezonit, shumëllojshmëria dhe cilësia e aktiviteteve.

Objektivat ekonomike: rritja e numrit të bizneseve në akomodim, ushqim, guidë lokale, transport dhe në efekt të zinxhirit ushqimor me ushqim dhe shërbime.

- ✓ Shërbime të reja turistike në Temal dhe Shllak (shndërrimi i disa shtëpive/kullave, fermave në bujtina dhe agroturizmi, ofrimi i orientimeve turistike nga banorët e zonave, rreth 5-10 sipërmarrje të reja).
- ✓ Shërbimet turistike në Koman për të përballuar një dyfishim të fluksit në 5 vjet, ofrojnë një kapacitet shtesë akomodes deri në dyfish dhe me rritjen e ofruesve të shërbimeve turistike krijohen mbi 30 sipërmarrje të reja (rritje e kapaciteteve akomoduese me disa bujtina, hotele, kampingje në zona, shtimi i disa njësive të furnizimit me ushqime, shtimi i numrit të guidave turistike lokale, shtimi i disa ofruesve të aktiviteteve ujore rekreative, shtimi i disa ofruesve të transportit turistik).

Objektivat mjedisore:

Duke qenë se burimi kryesor turistik i zonës është mjedisi natyror dhe peizazhi, ruajtja e natyrës nga pikëpamja e ruajtjes së vlerave të biodiversitetit, ruajtja e peizazhit nga ndërhyrjet infrastrukturore dhe ndërtimore, ruajtja e cilësisë së mjedisit nga ndotja, duke përfshirë mbetjet, dhe ndërveprimet mjedisore mbetet një prioritet strategjik.

Prioritetet:

Kompletimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në destinacion

- ✓ Turistët që qëndrojnë në Koman kanë mundësinë të lëvizin dhe të ecin gjatë orëve të darkës në një ambient të mbushur me ndriçim (ndriçimi në segmentet Vila Franceze – Ura dhe përgjatë bregut të liqenit drejt godinës së njësive administrative dhe kishës) dhe me shtigjet e ecjes përgjatë bregut të liqenit.
- ✓ Përfundimi i funksionimit si qendër shërbimi urban: *lehtësimit i ofrimit të shërbimeve bazë si furrë buke, riparim makinash, farmaci, shërbim mjekësor.*
- ✓ Në Koman, në liqenin e Vaut të Dejës funksionon moli i transportit ujor me Vaun e Dejës.
- ✓ Trafiku gjatë sezonit drejt tunelit të kalata e liqenit të Komanit menaxhohet në bazë të rregullave të komunikimit me një sistem tabelash sinjalistike që drejton nivelin, parkimin dhe autorizimin e kalimit të mjeteve që udhëtojnë drejt tragetit.
- ✓ Informacioni turistik gjatë sezonit jepet në një pikë informacioni turistik.

Zhvillimi dhe konsolidimi i ofertës së turizmit natyror, kulturor dhe rural.

- ✓ Udhëtimet drejt Temalit dhe Shllakut organizohen mbi bazën e shtigjeve që plotësojnë standardet e guidave: *të kompletuara me sinjalistikë, të vendosura dhe të disponueshme në hartën dixhitale në internet, të mirëmbajtura dhe me guida lokale.*
- ✓ Në itineraret e Temalit dhe Shllakut, interpretimi i historisë dhe traditave të zonave pasurohet me interpretimin e guidave lokale, dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpinë e fermës dhe në kohën e muzeut historik lokal.
- ✓ Kalatë e Dalmacisë dhe Sardës pajisen me infrastruktura interpretuese që paraqesin elementet kyçe të historisë, pozicionit gjeografik, shtrirjes dhe arkitekturës urbane, historisë dhe mënyrës së jetesës së popullsisë në periudhat mesjetare.

Mbështetja e biznesit dhe komunitetit në ofrimin e shërbimeve

- ✓ Përfundimi i shërbimeve të akomodimit me bujtina, kampingje të reja në Koman dhe Temal.
- ✓ Sipërmarrësit në fushën e turizmit ofrojnë shërbime në përputhje me standardet bazë, duke u mbështetur nga këshilla, asistencë teknike dhe trajnime dhe infrastrukturë turistike.
- ✓ Komuniteti i zonës ofron integrimin e produkteve vendore në industrinë me vlerë në turizëm, mbështetur nga lehtësimi dhe projekti.

Ambient turistik

Peizazhi natyror ruhet përmes ndërmarrjes së masave planifikuese dhe planeve individuale:

- ✓ përcaktimi i vendndodhjeve të objekteve rekreative,
- ✓ rregulloret për peizazhin dhe ndërtesat pranë zonës së aktivitetit,
- ✓ rregulloret për aktivitetet e vizitorëve në mbrojtjen e mjedisit,
- ✓ masat e planifikimit për kapacitetin mbajtës të turistëve në zonat natyrore,
- ✓ masat promovuese, informuese dhe rregullatore që bëjnë të mundur vizitën e destinacionit nga turistë që janë përgjegjës për natyrën.

Ruajtja e mjedisit nga ndotjet realizohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit sistematik të planeve për menaxhimin e ndotjeve që përfshijnë ndërtimin e infrastrukturës së shërbimeve të depozitimit dhe grumbullimit të mbetjeve në zonë dhe planit të masave për ndërgjegjësimin, informimin dhe bashkëpunimin e vizitorëve dhe bizneseve në ruajtjen e mjedisit.

2.5.2 Lugina e Drinit me liqenin e Vaut të Dejes, ofertë e integruar e tureve rekreative kulturore-natyre-ujore.

Profili: Lugina e Drinit, një peizazh lumor rrëzë Alpeve, peizazhi dhe zona historike – “autostrada historike” që ka lidhur bregdetin e Adriatikut me territorin e Kosovës, me lëvizjet dhe migrimet e popullsisë shqiptare, duke kontribuar në vazhdimësinë e historisë nga lashtësia deri në mesjetë shqiptare.

Oferta integrale me fjetje me Komanin dhe oferta për aktivitetet e përditshme turistike. Paketat turistike janë të integruara në ofertën rajonale.

Atraksionet dhe aktivitetet kryesore:

- ✓ Kalatë e Dalmacës, Sardës dhe Dejës
- ✓ Udhëtime me varkë në liqen
- ✓ Rekreacion dhe kalim i kohës së lirë me shëtitje në këmbë dhe biçikletë përgjatë vijës ujore të Mjedës dhe Vaut të Dejës

Profili i turizmit: Turizmi natyror i ndërthurur me turizmin kulturor dhe aktivitete rekreative ujore, në përputhje me planin kombëtar të Alpeve.

Tregu i synuar: vizitorët ndërkombëtarë, kombëtarë dhe rajonalë të turizmit të natyrës dhe kulturës me një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Objektivat e turizmit: rritja e netqëndrimeve të turistëve, rritja e fluksit, shërbimi sipas standardeve, mikpritja lokale.

Objektivat ekonomike: rritja e volumit dhe e të ardhurave, rritja e efektit zinxhir në ekonomi në lidhje me bujqësinë, rritja e punësimit.

Objektivat sociale: reduktimi i migracionit në zonat rurale, përfshirja e të rinjve dhe grave në shërbimet turistike

Objektivat mjedisore: ruajtje e mjedisit dhe peisazhit, reduktimi i ndotjeve

Objektivat për ofertën turistike të destinacionit:

- ✓ Ka oferta dhe shërbime të rregullta për udhëtimet me varkë në Koman, Sardë.
- ✓ Ka oferta dhe shërbime të rregullta për aktivitete rekreative ujore si kanoe. Ka oferta dhe shërbime për aktivitete në plazh.
- ✓ Organizimi i rrugës së kombinuar kulturore dhe natyrore që përfshin Kalatë e Dalmacës, Sardës dhe Dejës.
- ✓ Ka një infrastrukturë me shtigje të sheshuara, të mirëmbajtura, me stola për lëvizje rekreative që lidh qendrat e Vaut të Dejës dhe Mjedës dhe përgjatë vijës së tyre ujore.

Objektivat për shërbimet turistike

- ✓ Shërbime turistike në pellgun e liqenit të Vaut të Dejës : minimumi 20 gjithsej,
- ✓ Shtimi i disa njësive (min. 5) të shërbimeve turistike për rekreacion në plazh dhe shërbim lokal në zonën bregdetare,
- ✓ shtimi i disa njësive (2-3) në ofertën e akomodimit me kampingje,
- ✓ shtimin e disa njësive të aktiviteteve rekreative ujore,
- ✓ Shtimi i ofruesve të guidave lokale dhe transportit turistik (rreth 10).

Ambient turistik

Ruajtja e mjedisit nga ndotja realizohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit sistematik të planeve për menaxhimin e ndotjes që përfshijnë ndërtimin e infrastrukturës së shërbimeve të depozitimit dhe grumbullimit të mbetjeve në zonë dhe planit të masave për ndërgjegjësimin, informimin dhe bashkëpunimin e vizitorëve dhe bizneseve në ruajtjen e mjedisit.

Prioritetet për objektivin e objektivave:

Ndërtimi i infrastrukturës turistike që mundëson aktivitete ujore, aktivitete në plazh, ecje përgjatë vijës ujore dhe në qendrat e banuara të Mjedës dhe Vaut të Dejës dhe vizita në kalatë e Dalmacisë, Sardës dhe Dejës.

Integrimi i rrugës ujore përgjatë bedit Mjede-Laç i Vaut të Dejës-Qafa e Gurit si atraksion për aktivitete rekreative në këmbë dhe me biçikletë duke ndërtuar infrastrukturën bazë – ndriçim – sistem rrugor – stola.

Mbështetje për ofrimin e infrastrukturës bazë të plazhit, kanove, lojërave për fëmijë, shëtitjeve në natyrë dhe shërbimeve të bar-restoranteve në dy plazhet e Qafës së Gurit.

Lehtësimi dhe rregullimi i ofrimit të shërbimit të linjës së transportit turistik Qafa e Gurit – Koman – Sardë, duke filluar me bankën portative deri në investimin e plotë të kalatave Qafa e Gurit, Sardës, Komanit dhe më pas në 2-3 pika të tjera.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe sinjalistikës së aksesit të kalasë së Dejës dhe ndërtimi i infrastrukturës interpretuese për Dejën, Sardën dhe Dalmacën.

Mbështetje për produktin e kombinuar të turizmit të kulturës dhe natyrës

- ✓ Krijimi i një pakete interpretimi të historisë së zonave dhe vendndodhjes së kalasë
- ✓ Trajnimi i guidave lokale
- ✓ Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ndërtimit të linjave të transportit turistik në liqenin e Vaut të Dejës
- ✓ Plotësimi i hartave dhe promovimi i programit për agjencitë turistike që mund të ofrojnë paketa
- ✓ Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës pranë plazheve

Ambienti turistik

Peizazhi natyror i bregut të liqenit ruhet nëpërmjet ndërmarrjes së masave dhe planeve planifikuese: *përcaktimi i lokacioneve për aktivitete rekreative, rregullore për peizazhin dhe ndërtesat pranë zonës natyrore dhe rregulloret për aktivitetet e vizitorëve për mbrojtjen e mjedisit.*

Ruajtja e mjedisit nga ndotja realizohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit sistematik të planeve të menaxhimit të ndotjes që përfshijnë ndërtimin e infrastrukturës së shërbimeve të depozitimit dhe grumbullimit të mbetjeve në zonë dhe planin e masave për ndërgjegjësimin, informimin dhe bashkëpunimin e vizitorëve dhe bizneset në ruajtjen e mjedisit.

2.5.3 Bushat – Dioqeza e Sapës, oferte e turizmit kulturor, agroturizmit dhe hoteleve me pishina dhe spa.

Pozicionimi i ofertës turistike:

Si një nga zonat me vazhdimësinë e historisë së zonës së Shkodrës, me Basaninë e lashtë, trashëgimia e emrit të Barbullushit nga ushtarët romakë, vendi i pallateve të Bushatllinjve, një territor me vazhdimësi të traditave fetare të Kishës Katolike në Shqipëri, vendlindja e Frang Bardhit dhe Ndre Mjedës.

Turizmi kulturor në Bushat-Hajmel me piknisje Betlehemin e gjallë.

Tregu i synuar: turistët ndërkombëtarë dhe kombëtarë të cilët udhëtojnë me biçikletë, autokamper, makinë, grupe për të qëndruar në hotelet e Bushatit, kanë vizituar Komanin, Shkodrën, Shëngjinin, Velipojën.

Objektivat: pasurimi i ofertës, integrimi i historisë, integrimi i traditave bujqësore të zonës,

Oferta turistike

- ✓ Ka oferta me Itinerare me makinë, me grupe, për biçikleta që lidhin pika historike, monumente kulture, ferma apo pika me interes agroturizmi si punishte artizanale vere dhe vaj ulliri.
- ✓ Ka oferta dhe itinerare për shëtitje në natyrë në malin e Bushatit dhe zonën e Sapës.
- ✓ Ekziston një ofertë interpretuese e historisë dhe trashëgimisë së zonave nga guida lokale.
- ✓ Pikat historike si vendndodhja e pallateve të Bushatllinjve, vendndodhja e gërmimeve arkeologjike të Basanisë së lashtë dhe monumentet kulturore ose fetare si Dioqeza e Sapës, kishat, shtëpia e Ndre Mjedes janë të pajisura me infrastrukturën interpretuese dhe të aksesueshme në një bazë të një orari ose programi të miratuar nga drejtuesit e tyre.
- ✓ Traditat e zonës ofrohen nëpërmjet aktiviteteve kulturore, muzeve etnografike, përfshirjes së zotëruesve të historive apo traditave të zonës në interpretimin turistik.
- ✓ Një përzgjedhje fermash dhe pikash me interes agroturizmi si vera, vaji, artizanati janë pjesë e ofertës dhe itinerareve turistike në zonë.
- ✓ Betlehem i gjallë është një aktivitet i përbashkët kulturor vjetor, i organizuar në formë të konsoliduar në bashkëpunim me aktorët vendas me një infrastrukturë shërbimi të kombinuar në formën e një panairi.

Objektivat e turizmit: plotësimi i ofertës turistike të territorit të bashkisë, shtimi i qendrave të internetit, rritja e fluksit të vizitave, rritja e interesit për turet në zonë.

Objektivat ekonomike: punësimi i të rinjve, efektet në promovimin e produktit

Shërbimet turistike në zonën e Bushat-Hajmelit – shtimi i guidave lokale dhe ofruesve të transportit turistik (5-10), shtimi i fermave, njësive agroturistike apo familjeve që mirëpresin turistët me traditat e tyre historike dhe tradicionale (min.5).

Objektivat sociale: përfshirja e komunitetit në zinxhirin e vlerave, përfshirja e të rinjve si guida lokale.

Prioritetet:

Zhvillimi i produktit turistik

- ✓ Ndërtimi i narrativave që raportojnë historinë dhe traditat dhe trajnimin e drejtuesve lokalë.
- ✓ Ndërtimi i një programi vjetor të aktiviteteve kulturore dhe panairëve të promovuara gjatë gjithë vitit nga zyra e turizmit.
- ✓ Ndërtimi i tureve dhe vendosja e tyre në formë dixhitale në faqen e zyrës së bashkisë.
- ✓ Integrimi i hoteleve në dhënien e informacionit rreth tureve dhe itinerareve në zonën përreth.

- ✓ Një përzgjedhje fermash dhe pikash me interes agroturizmi si vera, vaji, artizanati janë pjesë e ofertës dhe itinerareve turistike në zonë.
- ✓ Betlehemi i gjallë është një veprimtari kulturore vjetore e organizuar rregullt, në formë të konsoliduar në bashkëpunim me aktorët vendas me një infrastrukturë shërbimi të kombinuar në formën e një panairi.
- ✓ Vendet turistike bëhen të aksesueshme bazuar në një orar dhe procedurë të krijuar në bashkëpunim me pronarët e tyre dhe ky informacion përditësohet dhe sigurohet nga zyra e turizmit.

Zhvillimi i infrastrukturës turistike

Ndërtimi i infrastrukturës interpretuese në atraksione: si siti arkeologjik e cila vlerësohet si Basania e lashtë, vendndodhja e sarait të Bushatllinjve, mbështetje për një muze etnografik (edhe me iniciativën ekzistuese të banorëve të zonës, siç është nisma e Ndoc Shaben).

Zhvillimi i Infrastruktures

- ✓ Hajmel – rinovimi i sheshit kryesor si qendër shërbimi dhe aktiviteti.

Mbështetja e shërbimeve turistike


- ✓ Trajnim për udhërrëfyes.
- ✓ Trajnimi i stafit të recepsionit të hoteleve.

Informacion turistik

- ✓ Informacion dhe harta turistike pranë zyrave të informacionit turistik dhe në hotele.

◆ 2.6 Objektivat strukturore

Sektori i menaxhimit të destinacionit turistik në bashki – funksionet



Menaxhimi i turizmit në bashkinë e Vaut të Dejës
Menaxhimi i destinacionit turistik me qendër një strukturë profesionale,
si pjesë e zhvillimit ekonomik lokal, në bashkëpunim me aktorët
e brendshëm dhe të jashtëm të bashkisë.

Fushat prioritare të zhvillimit të turizmit dhe masat prioritare për Bashkinë Vau i Dejës

3. PLANI I VEPRIMIT

- ◆ **3.1** Krijimi i strukturave të zhvillimit ekonomik dhe turizmit
- ◆ **3.2.** Ndërtimi i kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit duke praktikuar aspektet e bashkëpunimit dhe zbatimin e planit të miratuar të zhvillimit të turizmit.
- ◆ **3.3.** Hartimi i projekteve dhe ndarja e buxhetit përfshin ndarjen buxhetore që përfshin aktivitetet e festave, panairove, informacionit.

3.1 KRIJIMI I STRUKTURAVE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

Masat:

1. Aprovim i strukturës
2. Plotësim i organikës.
3. Plotësim i regullores

Përgjegjësite dhe burimet:

Kryetari I bashkise në bashkëpunim me zyrën e personelit dhe financës bën rishikimin e miratimit të strukturës dhe parashikon burimet përkatëse për pagesën e personelit dhe logjistikës përkatëse.

Ndërtimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të turizmit duke praktikuar aspektet e bashkëpunimit dhe duke zbatuar planin e miratuar të zhvillimit të turizmit

- ✓ Ndërtimi i rrjetit të grupeve të interesit dhe platformave të konsultimit
- ✓ Bashkëpunimi për hartimin e planeve të qendrave të destinacioneve
- ✓ Bashkëpunimi për infrastrukturën e shtigjeve
- ✓ Bashkëpunimi për projektet e infrastrukturës
- ✓ Hartimi i planit të panairove dhe aktiviteteve kulturore
- ✓ Ndërtimi i zyrës së informacionit turistik
- ✓ Ndërtimi i platformës së internetit

Përgjegjësitë:

Zyra e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është përgjegjëse për zbatimin e planit të zhvillimit të turizmit. Në hapat e parë mund të jetë e nevojshme asistencë teknike dhe është i nevojshëm hartimi i një projekt-fishe për financimin e mbështetjes teknike të këshillimit për fillimin e funksionimit të zyrës. Një projekt i tillë për një ndihmë fillestare mund të realizohet në një buxhet prej **10,000 – 30,000** Euro.

1.3 Hartimi i projekt-fishave dhe alokimi i buxhetit, duke përfshirë aktivitetet e festave, panairove, informacionit

Zyra e turizmit në bashkëpunim me zyrën e projekteve dhe sipas rastit me zyrat e tjera bashkiake dhe kur është e mundur dhe në bashkëpunim me projekte donatore, zhvillon projekt-fisha me buxhetin përkatës për masat e parashikuara në planin e zhvillimit të turizmit dhe bashkëpunon aktivisht në proceset e përfshirjes së këtyre masave në projekt-buxhetet e bashkisë, si dhe në bashkëpunim me zyrën e projektit në mënyrë proaktive, kërkon mundësi për aplikimin e bashkisë në projekte të ndryshme donatore që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave:

- 2.1 Konsiderimi i Komanit si qendër shërbimesh turistike që ka nevojë si për plan përmirësimi të mjedisit të zones së banuar dhe infrastrukturës
- 2.2 Projekti i ndriçimit të itinerarit Mjede-Vau i Dejës-Qafa e Gurit për të krijuar mundësinë e lëvizjes gjatë darkës për turistët dhe banorët për shërbime dhe rekreacion.
- 2.3 Zhvillimi i infrastrukturës së plazheve dhe kalatave në liqenin e Vaut të Dejës
- 2.4 Kompletimi i qendrës së Hajmelit me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime dhe panairove

Masat e mësipërme zbërthehen në projekte zbatimi në fushat specifike prioritare të këtij plani sipas kategorive si infrastruktura, produkti turistik etj.

Kjo fushë prioritare përfshihet në plan për të orientuar zhvillimin e kordinuar në nivel destinacioni.

PRIORITETET PËR DESTINACIONIN E KOMANIT

Prioritetet:

Kompletimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në destinacion

- ✓ Turistët që qëndrojnë në Koman kanë mundësinë të lëvizin dhe të ecin gjatë orëve të darkës në një ambient të mbushur me ndriçim (ndriçimi në segmentet Vila Franceze – Ura dhe përgjatë bregut të liqenit drejt godinës së njësise administrative dhe kishës) dhe me shtigjet e ecjes përgjatë bregut të liqenit.
- ✓ Përfundimi i funksionimit si qendër shërbimi urban: *lehtësimi i ofrit të shërbimeve bazë si furrë buke, riparim makinash, farmaci, shërbim mjekësor.*
- ✓ Në Koman, në liqenin e Vaut të Dejës funksionon moli i transportit ujor me Vaun e Dejës.
- ✓ Trafiku gjatë sezonit drejt tunelit të kalatave e liqenit të Komanit menaxhohet në bazë të rregullave të komunikimit me një sistem tabelash sinjalistike që drejton nivelin, parkimin dhe autorizimin e kalimit të mjeteve që udhëtojnë drejt tragetit.
- ✓ Informacioni turistik gjatë sezonit jepet në një pikë informacioni turistik.

Zhvillimi dhe konsolidimi i ofertës së turizmit natyror, kulturor dhe rural

- ✓ Udhëtimet drejt Temalit dhe Shllakut organizohen mbi bazën e shtigjeve që plotësojnë standardet e guidave: të kompletuara me sinjalistikë, të vendosura dhe të disponueshme në hartën dixhitale në internet, të mirëmbajtura dhe me guida lokale.
- ✓ Në itineraret e Temalit dhe Shllakut, interpretimi i historisë dhe traditave të zonave pasurohet me interpretimin e guidave lokale, dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpinë e fermës dhe në kohën e muzeut historik lokal.
- ✓ Kalatë e Dalmacisë dhe Sardës pajisen me infrastruktura interpretuese që paraqesin elementet kyçe të historisë, pozicionit gjeografik, shtrirjes dhe arkitekturës urbane, historisë dhe mënyrës së jetesës së popullsisë në periudhat mesjetare.

Mbështetja e biznesit dhe komunitetit në ofrimin e shërbimeve

- ✓ Përfundimi i shërbimeve të akomodimit me bujtina, kampingje të reja në Koman dhe Temal.
- ✓ Sipërmarrësit në fushën e turizmit ofrojnë shërbime në përputhje me standardet bazë, duke u mbështetur nga këshilla, asistencë teknike dhe trajnime dhe infrastrukturë turistike.
- ✓ Komuniteti i zonës ofron integrimin e produkteve vendore në industrinë me vlerë në turizëm, mbështetur nga lehtësimi dhe projekti.

Ambient turistik

- ✓ Peizazhi natyror ruhet përmes ndërmarrjes së masave planifikuese dhe planeve individuale: përcaktimi i vendndodhjeve të objekteve rekreative, rregulloret për peizazhin dhe ndërtesat pranë zonës së aktivitetit, rregulloret për aktivitetet e vizitorëve në mbrojtjen e mjedisit, masat e planifikimit për kapacitetin mbajtës të turistëve në zonat natyrore, masat promovuese, informuese dhe rregullatore që bëjnë të mundur vizitën e destinacionit nga turistë që janë përgjegjës për natyrën.
- ✓ Ruajtja e mjedisit nga ndotjet realizohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit sistematik të planeve për menaxhimin e ndotjeve që përfshijnë ndertimin e infrastrukturës së shërbimeve të depozitimit dhe grumbullimit të mbetjeve në zonë dhe planit të masave për ndërgjegjësimin, informimin dhe bashkëpunimin e vizitorëve dhe bizneseve në ruajtjen e mjedisit.

PRIORITETET PER DESTINACIONIN E LUGINËS SË DRINIT – VAU I DEJËS

- ✓ Ndërtimi i infrastrukturës turistike që mundëson aktivitete ujore, aktivitete në plazh, ecje përgjatë vijës ujore dhe në qendrat e banuara të Mjedës dhe Vaut të Dejës dhe vizita në kalatë e Dalmacisë, Sardës dhe Dejës.
- ✓ Integrimi i rrugës ujore përgjatë bendit Mjede-Laç i Vaut të Dejës-Qafa e Gurit si atraksion për aktivitete rekreative në këmbë dhe me biçikletë duke ndërtuar infrastrukturën bazë – ndriçim – sistem rrugor – stola.
- ✓ Mbështetje për ofrimin e infrastrukturës bazë të plazhit, kanove, lojërave për fëmijë, shëtitjeve në natyrë dhe shërbimeve të bar-restoranteve në dy plazhet e Qafës së Gurit.

- ✓ Lehtësimi dhe rregullimi i ofrimit të shërbimit të linjës së transportit turistik Qafa e Gurit – Koman – Sardë, duke filluar me bankën portative deri në investimin e plotë të kalatave Qafa e Gurit, Sardës, Komanit dhe më pas në 2-3 pika të tjera.
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës dhe sinjalistikës së aksesit të kalasë së Dejës dhe ndërtimi i infrastrukturës interpretuese për Dejën, Sardën dhe Dalmacën.
- ✓ Mbështetje për produktin e kombinuar të turizmit të kulturës dhe natyrës
- ✓ Krijimi i një pakete interpretimi të historisë së zonave dhe vendndodhjes së kalasë
- ✓ Trajnimi i guidave lokale
- ✓ Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ndërtimit të linjave të transportit turistik në liqenin e Vaut të Dejës
- ✓ Plotësimi i hartave dhe promovimi i programit për agjencitë turistike që mund të ofrojnë paketa
- ✓ Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës pranë plazheve
- ✓ Ambienti turistik
- ✓ Peizazhi natyror i bregut të liqenit ruhet nëpërmjet ndërmarrjes së masave dhe planeve planifikuese: përcaktimi i lokacioneve për aktivitete rekreative, rregullore për peizazhin dhe ndërtesat pranë zonës natyrore dhe rregulloret për aktivitetet e vizitorëve për mbrojtjen e mjedisit.
- ✓ Ruajtja e mjedisit nga ndotja realizohet nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit sistematik të planeve të menaxhimit të ndotjes që përfshijnë ndërtimin e infrastrukturës së shërbimeve të depozitimit dhe grumbullimit të mbetjeve në zonë dhe planin e masave për ndërgjegjësimin, informimin dhe bashkëpunimin e vizitorëve dhe bizneset në ruajtjen e mjedisit

PRIORITETET PER DESTINACIONIN BUSHAT – HAJMEL

Zhvillimi i produktit turistik

- ✓ Ndërtimi i narrativave që raportojnë historinë dhe traditat dhe trajnimin e drejtuesve lokalë
- ✓ Ndërtimi i një programi vjetor të aktiviteteve kulturore dhe panairove të promovuara gjatë gjithë vitit nga zyra e turizmit
- ✓ Ndërtimi i tureve dhe vendosja e tyre në formë dixhitale në faqen e zyrës së bashkisë
- ✓ Integrimi i hoteleve në dhënien e informacionit rreth tureve dhe itinerareve në zonën përreth
- ✓ Një përzgjedhje fermash dhe pikash me interes agroturizmi si vera, vaji, artizanati janë pjesë e ofertës dhe itinerareve turistike në zonë.
- ✓ Betlehem i gjallë është një veprimtari kulturore vjetore e organizuar rregullt, në formë të konsoliduar në bashkëpunim me aktorët vendas me një infrastrukturë shërbimi të kombinuar në formën e një panairi.
- ✓ Vendet turistike bëhen të aksesueshme bazuar në një orar dhe procedurë të krijuar në bashkëpunim me pronarët e tyre dhe ky informacion përditësohet dhe sigurohet nga zyra e turizmit.

Zhvillimi i infrastrukturës turistike

Ndërtimi i infrastrukturës interpretuese në atraksione: *si siti arkeologjik e cila vlerësohet si Basania e lashtë, vendndodhja e sarait të Bushatllinjve, mbështetje për një muze etnografik (edhe me iniciativën ekzistuese të banorëve të zonës, siç është nisma e Ndoc Shaben).*

Zhvillimi i Infrastruktures

- ✓ Hajmel – rinovimi i sheshit kryesor si qendër shërbimi dhe aktiviteti

Mbështetja e shërbimeve turistike

- ✓ Trajnim për udhërrëfyes
- ✓ Trajnimi i stafit të recepsionit të hoteleve

Informacion turistik

- ✓ Informacion dhe harta turistike pranë zyrave të informacionit turistik dhe në hotele

3.1.1 Zhvillimi i produktit të turizmit natyror me qendër destinacionin e Komanit

3.1.2 Zhvillimi i ofertës së itinerareve kulturore-natyrore-historike për zonën e Vaut të Dejës, Bushat-Hajmel.

3.1.3 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve kulturore

3.1.4 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve rekreative ujore

3.1.5 Zhvillimi i ofertës për turizmin me biçikleta

3.1.6 Zhvillimi i ofertës për turizmin rural në Bushat-Hajmel

3.1.1 Zhvillimi i produktit të turizmit natyror me qendër destinacionin e Komanit

3.1.1.1 Itineraret e ecjes në natyrë në zonën e Temalit dhe Shllakut plotësojnë standardet bazë me sinjalistikë, me mirëmbajtje periodike të shtigjeve, vendosen në formë dixhitale në inventarin e bashkisë dhe promovohen në faqen e turizmit të bashkisë. Zyra e informacionit turistik në Bashki dhe rrjeti i informacionit në zyra dhe hotele të tjera japin informacion ndërsa ka oferta për turne me guida dhe ofrohen nga guida lokale të certifikuara.

Përshkrimi i programit

Një sërë itinerarësh për shëtitjet në natyrë janë postuar nga të apasionuarit e shëtitjeve në natyrë në platformat online si wikiloc, ndërkohë që disa prej tyre janë shënuar në terren nga projekte të ndryshme por ende nuk janë në inventarin e bashkisë. Është e nevojshme që itineraret aktuale ku ecin turistët me dhe pa guidë të inventarohen si shtigje, të futen në inventarin e bashkisë, të monitorohen për nevojat për mirëmbajtje dhe rregullime, si dhe të vlerësohet situata për sinjalistikën dhe të hartohen projekte për përmirësim të sinjalistikës.

Është e nevojshme të trajnohen udhërrëfyes lokalë për të ofruar udhëzime lokale.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Inventari mund të bëhet në bashkëpunim me zyrën e turizmit dhe drejtorinë e pyjeve. Ata mund të bashkëpunojnë me guidat lokale dhe grupet e entuziastëve të ecjes që veprojnë në këto zona. Mirëmbajtja mund të bëhet nga drejtoria e pyjeve në bashkëpunim me aktorët e mësipërm. Vlerësimi i nevojës për sinjalistikën turistike dhe plotësimi i sinjalistikës mund të bëhet në këto bashkëpunime dhe me bashkëpunim projekt.

Buxheti

Hartimi i një projekti asistence për kryerjen e inventarit në terren dhe dixhital mund të jetë në intervalin **20,000 - 30,000 euro**.

3.1.1.2 Në turet e ofruara në Temal dhe Shllak, interpretimi i historisë dhe traditave të zonës dhe vlerave të biodiversitetit pasurohet me interpretimin e guidave lokale, vizitat dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpi dhe ferma dhe në ekspozime ose muzetë historikë lokalë.

Përshkrimi i projektit

Ekoturizmi është një trend i tregut ndërkombëtar, por edhe një element i rëndësishëm i turizmit të qëndrueshëm në zonat natyrore. Interesi i ekoturistëve është njohja e vlerave natyrore dhe komunitetit të tyre. Zona e Alpeve, duke përfshirë njësitë e Temalit dhe Shllakut, zotëron vlera të biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore dhe jetës rurale, të cilat ende nuk janë integruar në itineraret aktuale të ecjes në natyrë.

Nevojitet një vlerësim i thelluar i vlerave të biodiversitetit, i cili mund të integrohet në ofertën turistike të tureve me sinjalistikë interpretuese dhe guida të specializuara që dinë dhe janë të trajnuar për të paraqitur këto vlera.

Në këtë mënyrë nevojitet një vlerësim i thelluar i historisë, trashëgimisë kulturore, traditave të zonës për të ndërtuar narrativën interpretuese turistike. Pika të rëndësishme me interes historik, monumente dhe objekte të trashëgimisë kulturore duhet të përfshihen në ofertë dhe duhet të kenë narrativën e tyre prezantuese për turistët. Në mënyrë të ngjashme, familjet individuale që trashëgojnë dhe mund të tregojnë ose demonstrojnë elementë të kësaj trashëgimie, duhet të identifikohen dhe të integrohen në ofertën turistike. Duhet vlerësuar situata dhe duhet hartuar një projekt për të mbështetur një muze lokal, privat apo jo, për vlerat etnografike dhe historinë e zonës.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zhvillimi i një projekti të fokusuar për integrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në zonën e Temalit dhe Shllakut, është i domosdoshëm ku bashkia mund të kërkojë një aplikim në bashkëpunim me organizata të ndryshme në rastet e mundësive të financimit për projekte që fokusohen mbi turizmin. trashëgiminë kulturore, ruajtjen e biodiversitetit, zhvillimin rural.

Vlera buxhetore e projektit: **50.000-100.000 euro**

3.1.2 Zhvillimi i ofertës së itinerareve kulturore-natyrore-historike për zonën e Vaut të Dejës, Bushat-Hajmel.

3.1.2.1 Integrimi i burimeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në ofertën turistike

- ✓ Ndërtimi i narrativës së prezantimit të historisë dhe traditave dhe trajnimi i guidave lokale
- ✓ Identifikimi i pikave dhe burimeve turistike që kanë nevojë për një program interpretimi, sinjalistikë interpretuese. Vendet turistike janë të aksesueshme bazuar në një orar dhe procedurë të krijuar në bashkëpunim me pronarët e tyre dhe ky informacion përditësohet dhe sigurohet nga zyra e turizmit.
- ✓ Ndërtimi i tureve dhe promovimi i tyre

Përshkrimi i programit

- ✓ Territori i zonës së Vaut të Dejës, Bushatit dhe Zadrimës ka një rol të veçantë në historinë e Shqipërisë: për nga momentet historike, trashëgimia kulturore, vazhdimësia historike, vlerat etnografike, personazhet, me një sërë monumentesh të trashëgimisë kulturore por që e gjithë kjo paketë nuk është lehtësisht e prekshme në ofertën turistike dhe prezantimin e këtyre vlerave për turistët.
- ✓ Nevojitet një vlerësim i thelluar i vlerave jomateriale si historia dhe tradita për t'u integruar në narrativën e interpretimit turistik. Nevojitet një projekt për zhvillimin e kësaj narrative për turizmin ku ekspertiza e trashëgimisë kulturore dhe turizmit duhet të kombinohen për të ndërtuar një ofertë të tillë. Kjo është një mundësi për të rinjtë dhe entuziastët e historisë dhe traditës që të përfshihen në gjetjen e rrugëve lokale. Po kështu për secilën nga pikat e rëndësishme si Kalaja e Danjës, Dalmacës, Vigut, Sardës, rrënojat ilire në Bushat, vendndodhja e pallateve të Bushatllinjve, Dioqeza e Sapës, kishat historike në Dejë, Nenshat etj. Të ketë një paketë e veçantë interpretimi dhe duhet të zhvillohet një paketë e sinjalistikës interpretuese.
- ✓ Po kështu, duhen identifikuar personazhet, familjet, shtëpitë që zotërojnë dhe mund të paraqesin vlera të trashëgimisë kulturore, tradita të zonës, si dhe të mbështeten iniciativat për muzetë vendas dhe privatë në mënyrë që ata të vizitohen nga turistët.
- ✓ Pikat turistike janë të aksesueshme në bazë të një orari dhe procedure të krijuar në bashkëpunim me pronarët e tyre dhe ky informacion përditësohet dhe sigurohet nga zyra e turizmit.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Përgatitja e një projekti nga zyra e turizmit të bashkisë për aplikim apo mbështetje për zhvillimin e turizmit kulturor.
- ✓ Vlera e mundshme buxhetore: **50.000 euro**
- ✓ Në lidhje me aksesin dhe programet interpretuese në objektet dhe kishat e trashëgimisë kulturore, duhet të bashkëpunohet me drejtorinë e monumenteve të kulturës dhe dioqezën e zonës.

3.1.3 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve kulturore

3.1.3.1 Integrimi i aktiviteteve kulturore dhe festave komunitare në ofertën turistike

Ne kemi nevojë për një vlerësim të vlerave dhe atyre aktiviteteve që mund të integrohen në ofertën turistike.

Vlerësimi i rëndësisë së aktiviteteve dhe vlerave që ato mund të kenë për integrimin në ofertën turistike.

Vlerësimi i programimit për integrimin e nevojës për një infrastrukturë shërbimi dhe kombinimin e paraqitjes së vlerave të tjera në formën e një panairi bashkëngjitur këtyre festave.

Vlerësimi i rolit të aktorëve të ndryshëm në organizim, financim dhe promovim.

3.1.3.2 Mbështetje për konsolidimin e aktivitetit Bethlehem i gjallë dhe zgjerimin e përvojës në aktivitete të tjera

Bethelemi i gjallë është një aktivitet kulturor i përvitshëm i organizuar rregullisht, në formë të konsoliduar në bashkëpunim me aktorët vendas me një infrastrukturë shërbimesh të kombinuara në formën e një panairi.

Bashkia merr pjesë në bashkëorganizimin, promovimin, mobilizimin e burimeve për vendin e veprimtarisë, infrastrukturën e aktivitetit, koordinimin e aktiviteteve që mund të aktivizojnë pjesëmarrjen e komunitetit në shfaqje kulturore apo pjesëmarrjen në panair.

3.1.3.3 Ndërtimi i një programi vjetor të aktiviteteve kulturore dhe panairove të promovuara gjatë gjithë vitit nga zyra e turizmit

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Zyra e turizmit, në bashkëpunim me kulturën dhe aktorë të tjerë të komunitetit, përcakton pjesën e buxhetit të bashkisë që duhet të integrohet me një zë të veçantë në buxhetin e zyrës së turizmit.
- ✓ Bashkia mund të sigurojë edhe një infrastrukturë bazë për aktivitetet si çadra, tavolina, foni dhe mund ta përdorë atë në çdo aktivitet.
- ✓ Bashkia mund të përcaktojë një buxhet bashkëfinancues për aktivitetet.
- ✓ Në varësi të mundësive të bashkisë, ky buxhet mund të ketë ndarje në intervalin prej **10,000 – 20,000 Euro në vit**.
- ✓ Bashkia merr pjesë në bashkëorganizimin, promovimin, mobilizimin e burimeve për vendin e veprimtarisë, infrastrukturën e aktivitetit, koordinimin e aktiviteteve që mund të aktivizojnë pjesëmarrjen e komunitetit në shfaqje kulturore apo pjesëmarrjen në panair.

3.1.4 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve rekreative ujore

3.1.4.1 Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ndërtimit të linjave të transportit turistik në liqenin e Vaut të Dejës.

Kombinohet me ndërtimin e infrastrukturës së molove portative në Vaun e Dejës, Sardë dhe Koman dhe me ofertat e tureve të kombinuara.

Por këtu është e rëndësishme të gjenden mënyra, qoftë edhe lehtësira të përkohshme, që operatorët që aktualisht operojnë dhe zotërojnë anije, të marrin përsipër këtë linjë.

Ky është një proces që kërkon moderim dhe integrim të aktiviteteve: përfshirja e agjencive turistike, guidave lokale që mund të ngjallin interesin se këto linja do të funksionojnë, si dhe ndërtimi i infrastrukturës së përhershme të kalatave, mund të nxisë angazhimin e operatorëve në këtë linjë.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e turizmit në bashkëpunim me atë të urbanistikës dhe shërbimeve publike si dhe me drejtorinë përkatëse të menaxhimit të mjeteve motorike në basenin ujqor.

3.1.4.2 Planifikimi dhe lehtësimi i procesit të ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës pranë plazheve

Nëpërmjet planifikimit dhe mundësisë së investimit publik apo privat, bashkia duhet të krijojë kushtet për sigurimin e infrastrukturës bazë për plazh, kanoe, lojëra për fëmijë, shëtitje në natyrë dhe shërbime bar-restorante në dy plazhet e Qafës së Gurit.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e turizmit në bashkëpunim me atë të urbanistikës dhe shërbimeve publike

3.1.5 Zhvillimi i ofertës për turizmin me biçikleta

- ✓ Inventari i rrugëve aktuale së bashku me informacionin përkatës.
- ✓ Vlerësimi i nevojave për informacion, sinjalistikë dhe shërbime përgjatë rrugëve.
- ✓ Ndërtimi i sinjalistikës, ndërtimi i tureve me pika interesi dhe shërbimesh dhe postimi në faqen e internetit dhe promovimi si në rrjetet sociale ashtu edhe në zyrat e informacionit turistik në Vau Dejës, Shkodër, Lezeh si dhe në rrjetin e hoteleve.
- ✓ Organizimi i tureve promovuese

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e turizmit krijon një bashkëpunim me rrjetin e entuziastëve të çiklizmit në Shkodër. Zyra e turizmit mund të hartojë një projekt për sinjalistikën dhe nevojat infrastrukturore të korsive të biçikletave në segmente të ndryshme.

3.1.6 Zhvillimi i ofertës së turizmit rural të kombinuar me turizmin kulturor për zonën Bushat – Hajmel

Ka një traditë të kultivimit për përpunimin e produkteve bujqësore në zonë, me ferma, pemishte, sera dhe disa fabrika të përpunimit të verës dhe vajit të ullirit. Ka edhe dy pika agroturizmi që ofrojnë ushqim në Hajmel dhe Melgushë.

Për promovimin e këtyre vlerave dhe produkteve si dhe pasurimin e ofertës turistike, është e nevojshme të identifikohen fermat dhe pikat e përpunimit që mund të vizitohen dhe të integrohen këto pika në itinerare dhe të ndërtohet një program interpretimi dhe vizite në këto pika.

Kombinimi i itinerareve me biçikleta, ecje në natyrë, drejtimi me makinë dhe ture në grup duke ndërthurur vlerat e turizmit rural dhe kulturor e bën më të plotë dhe konkurruese ofertën e tureve në zonën e Bushatit dhe Hajmelit, si pjesë që mund të të integrohen në ofertën e zonës nën-Shkodrës së bashku me Zadrimën.

Etiketatat narrative dhe të origjinës së destinacionit për produktet vendase kontribuojnë në marketingun e territorit dhe produktet vendase mund të ofrohen si suvenire për vizitorët.

Prezantimi i këtyre produkteve vendase në panairët lokale si përfaqësuese të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe rurale të zonës duhet të bëhet në mënyrë sistematike.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Zyra e turizmit në bashkëpunim me zyrën e bujqësisë.
- ✓ Një projekt për promovimin e produkteve vendase përmes etiketave narrative dhe origjinës së destinacionit mund të përgatitet për aplikim duke kërkuar bashkëpunimin e zonave të tjera përreth.
- ✓ Buxheti i projektit: **50.000 – 100.000 euro.**

3.2.1 Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit natyror: shtigje, sinjalisitike informacioni dhe interpretimi

3.2.2 Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit kulturor për aktivitete dhe panairë, panele informuese dhe promovuese

3.2.3 Zhvillimi i infrastrukturës turistike të itinerareve kulturore-natyrore-historike: sinjalistikë, informacion dhe interpretim.

3.2.4 Zhvillimi i infrastrukturës së plazheve

3.2.5 Zhvillimi i infrastrukturës portative të molove deri në ndërtimin e plotë të tyre

3.2.1. Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit natyror: shtigje, sinjalisitike informacioni dhe interpretimi

Udhëtimet në Temal dhe Shllak organizohen në bazë të shtigjeve që plotësojnë standardet e udhëzuesve: *të kompletuara me sinjalistikë, të transferuara dhe të disponueshme në hartat dixhitale në internet, të mirëmbajtura dhe me guida lokale.*

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës dhe sinjalistikës kërkon hartimin e një projekti të veçantë për aplikim tek donatorët. Vlera e buxhetit mund të jetë në intervalin **30,000-50,000 Euro.**
- ✓ Mirëmbajtja e infrastrukturës ka nevojë për një zë buxhetor vjetor. **5000-10000 euro.**

3.2.2 Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit kulturor: infrastrukturë për aktivitete dhe panairë

Përshkrimi i projektit

Në mënyrë që bashkia të ketë infrastrukturën e saj bazë për aktivitete si çadra, tavolina, foni dhe të mund ta përdorë atë në çdo aktivitet, mund të prokurojë dhe të ketë në inventar një infrastrukturë të pajisjeve të tilla.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e Turizmit dhe Kulturës harton një plan për prokurimin e infrastrukturës bazë, e cila më pas inventarizohet dhe ruhet pranë bashkisë dhe përdoret në rast aktivitetesh.

Buxheti: një fond prej **10.000 euro** mund të realizojë një infrastrukturë bazë.

3.2.3 Zhvillimi i infrastrukturës turistike të itinerareve kulturore-natyrore-historike: sinjalistikë, informacion dhe interpretim

Përshkrimi i programit

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës dhe sinjalistikës së aksesit në kalanë e Dejës dhe në këtë mënyrë për secilën nga pikat e rëndësishme si kalaja e Dejës, Dalmacës, Vigut, Sardës, rrënojat ilire në Bushat, vendndodhja e pallateve të Bushatllinjve, Dioqeza e Sapës, kishat historike në Dejë, Nenshat etj. për të zhvilluar një paketë sinjalizuese interpretuese.
- ✓ Kalatë e Dalmacisë dhe Sardës janë të pajisura me infrastrukturë interpretuese që paraqet elementet kyçe të historisë, pozicionit gjeografik, shtrirjes urbane dhe arkitekturës, historisë dhe stilit të jetesës së popullsisë në periudhat mesjetare në këto vendbanime.
- ✓ Ndërtimi dhe monitorimi i rrjetit të sinjalistikës turistike përgjatë rrugëve dhe rrugëve, inventarizimi dhe përditësimi i tij.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Zyra e turizmit në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të monumenteve të kulturës mund të hartojë një projekt të veçantë për të aplikuar tek donatorët dhe në bashkëpunim me OJF-të për realizimin e kësaj infrastrukture.
- ✓ Buxheti i projektit, i cili përfshin asistencën teknike dhe infrastrukturën përkatëse, mund të jetë në intervalin **50,000 – 100,000 Euro**.

3.2.4 Zhvillimi i infrastrukturës së plazheve

- ✓ Mbështetje për ofrimin e infrastrukturës bazë të plazhit, kanove, lojërave për fëmijë, shëtitjeve në natyrë dhe shërbimeve bar-restorante në dy plazhet e Qafës së Gurit.

3.2.5 zhvillimi i infrastrukturës së molove portative

- ✓ Lehtësimi dhe rregullimi i ofrimit të shërbimit të linjës së transportit turistik Qafa e Gurit – Koman – Sardë, duke filluar me molot portative deri në investimin e plotë të kalatave Qafa e Gurit, Sardës, Komanit dhe më pas në 2-3 pika të tjera.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Zyra e turizmit bashkëpunon me zyrën e urbanistikës, e cila është përgjegjëse për hartimin ose vënien në punë të projekteve të tilla.
- ✓ Buxheti për infrastrukturën portative të molove: Ka nevojë për hartimin e një projekti të veçantë.
- ✓ Gama e infrastrukturës portative të kalatave me konstruksione prej druri dhe metali që mundësojnë hipjen e sigurt të pasagjerëve mund të jetë në vlerë totale deri në **20.000 euro**.

Projekti: *vlërësimi i potencialeve dhe propozimeve për zhvillimin e përgjithshëm kaskadës së lumin Drin, financuar nga Korporata energjetike Shqiptare ne kuader te Pergjegjesise Sociale, dhe hartuar nga Studio Casanova-Hernandez në vitin 2020.*

Ky projekt ka perpiluar nje liste nderhyrjesh te mundshme ne kuader te nje Plani Zhvillimor të Kaskadës së Lumit Drin.



Plani Zhvillimor i Kaskadës së Lumit Drin përbëhet nga një sërë ndërhyrjesh që janë përqendruar në zonën e Vaut të Dejës HEC-i (*zona e studimit 1*), Komani (*zona e studimit 2*) dhe rezervuari i Vaut të Dejës (*zona e studimit 4*), që i lidh të dyja me ujë.

Objekti kryesor është krijimi i dy poleve turistike, një në Vau i HEC i Dejës dhe një në HEC Koman, i lidhur me një Sistem të transportit uhor përgjatë rezervuarit të Vaut të Dejës dhe një rrjet të vogël të atraksioneve turistike. Lidhja e re e ujit, ndërmjet Vau i Dejës dhe Komanit dhe ndërhyrjet e reja përgjatë gjithë zonës, synojnë ta shndërrojnë zonën në një zonë turistike tërheqëse dhe një destinacion që lidhet mirë me qytetin e Shkodrës dhe Alpet Shqiptare.


Plani i zhvillimit përbëhet nga shtatë ndërhyrje kryesore:

1. Muzeu Komanit i Hidrocentralit Shqiptar
2. Limani i Komanit dhe Qendra e Vizitorëve
3. Lidhja e ujit Vau I Dejës – Koman
4. Parku i Energjisë së Gjelbër të Vaut të Dejës
5. Parku Kulturor i Ishullit Sarda & Rrjeti i Kalatave te Vau i Dejës, Rezervuari
6. Qendra e Vizitorëve të Akuakulturës
7. Kabina me pamje nga liqeni





1.2 PATH OF THE ENERGY & PARKING



C. PRELIMINARY COST ESTIMATION C.1 PHASE 1

STRUCTURES NAME	TOTAL COST	SURFACE	COST/SURFACE	%
1. NATIONAL MUSEUM OF ALBANIAN HYDROPOWER	2.957.373	77.773,30		
1.1-NATIONAL MUSEUM OF ALBANIAN HYDROPOWER	1.253.627	1.557,30	805,00	
1.2-PATH OF THE ENERGY & PARKING	575.038	4.920,00	116,88	
1.3-PERISCOPE OVER KOMAN POWER STATION	123.110	245,00	502,49	
1.4-BELVEDERE OVER KOMAN DAM	27.467	51,00	538,56	
1.5-LAKESHORE RESTORATION AT KOMAN DAM	978.132	71.000,00	13,78	
2. KOMAN LAKE HARBOR & VISITOR CENTER	1.715.633	3.762,40		
2.1-PIER RENOVATION	933.251	2.912,00	320,48	
2.2 HARBOR BUILDING	782.382	850,40	920,02	
3. WATER CONNECTION VAU I DEJËS - KOMAN	1.703.622	73.927,00		
3.1-HARBOR & PARKING AT VAU I DEJËS HPP	346.725	5.027,00	68,97	
3.2-HARBOR & PARKING AT KOMAN HPP	604.773	18.000,00	33,60	
3.3-LAKESHORE RESTORATION AT KOMAN BRIDGE	752.124	50.900,00	14,78	
SUM	6.376.627			
20%VAT	1.275.325			
TOTAL SUM	7.651.953			

3.3.1 Planifikimi i aktiviteteve turistike në zonat natyrore, përcaktimi i vendeve për veprimtari turistike dhe lejet përkatëse

3.3.2 Rregulloret për arkitekturën e peizazhit, ndërtesat tradicionale dhe ndërtesat pranë peizazheve natyrore

3.3.3 Planifikimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në atraksione

3.3.4 Masat për mbrojtjen e mjedisit

3.3.5 Projektet për mjedisin urban

3.3.1 Planifikimi i aktiviteteve turistike në zonat natyrore, përcaktimi i vendeve për veprimtari turistike dhe lejet përkatëse

Zyra e turizmit, në bashkëpunim me drejtorinë e pyjeve, urbanistikës, duhet të detajojë planifikimin e aktiviteteve turistike në zonat natyrore, në përputhje me praktikën e mira. Kjo mund të arrihet edhe përmes hartimit të një dosjeje projekti për aplikim ose angazhim konsulence.

3.3.2 Rregulloret për arkitekturën e peizazhit, ndërtesat tradicionale dhe ndërtesat pranë peizazheve natyrore

- ✓ Të ndërtohet një rregullore për arkitekturën e peizazhit, ku të ketë parashikime për llojin dhe arkitekturën e ndërtimeve të lejuara, qoftë edhe të përkohshme, në mënyrë që ndikimi i tyre në peizazh të jetë i vogël dhe në harmoni.
- ✓ Po kështu, nevojitet një Rregullore për peizazhin rural dhe rinovimin e kullave.
- ✓ Aktualisht rregulloret urbanistike për zonën Shirokë-Zogaj dhe ajo për ndërtesat tradicionale në Theth janë referenca që mund të shërbejnë si model.
- ✓ Peizazhi i monumenteve të kulturës është i rëndësishëm, duke përfshirë territorin përreth, dhe duhet të trajtohet në bashkëpunim me monumentet e kulturës, dioqezën ku mund të ketë një rregullore, plan apo udhëzime për mundësitë e përmirësimeve dhe ndërhyrjeve në të ardhmen.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Rregulloret mund të hartohen në bazë të një projekti me mbështetjen e donatorëve, OJQ-ve
- ✓ Buxheti që mund të parashikohet për këto rregullore: **30,000-50,000 Euro**

3.3.3 Planifikimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në atraksione

- ✓ Nevojitet të ndërtohet një rregullore për infrastrukturën e vizitorëve si shtigjet, vendet e kampingut, rregulloret për përdorimin e vizitorëve të zonave natyrore.
- ✓ Ndërkohë që për këtë kategori infrastrukture të përdoret udhëzuesi për ndërtimin e shtigjeve nga AKZM.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Rregulloret mund të hartohen në bazë të një projekti me mbështetjen e donatorëve, OJQ-ve
- ✓ Buxheti që mund të parashikohet për këto rregullore: 30,000-50,000 Euro

3.3.4 Masat për mbrojtjen e mjedisit

- ✓ Kuadri ligjor dhe planet e menaxhimit të baseneve kanë parashikuar përgjegjësi dhe masa mbrojtëse dhe menaxhuese për burimet ujore. Në interes të turizmit, bashkëpunimi dhe monitorimi i ruajtjes së cilësisë së këtyre burimeve, veçanërisht për shfrytëzimin e plazheve, duhet të jetë një linjë prioritetesh veçanërisht për zyrën e menaxhimit të turizmit në bashkëpunim me struktura të tjera.
- ✓ Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, si në zonat natyrore, ashtu edhe në qendrat e shërbimit turistik, ka nevojë për një paketë masash të veçanta dhe të programuara, me instrumente dhe infrastrukturë të veçantë ku bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi me bizneset, komunitetin dhe vizitorët është jetik.

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Drejtoria e shërbimeve, sektori i mjedisit, agjensitë rajonale që trajtojnë mjedisin.

3.3.5 Projektet për mjedisin urban

Atraktiviteti për turizmin e mjedisit të njësive të banimit dhe organizimi i shërbimeve turistike për qendrat e interesit si Komani, Mjeda dhe Vau i Dejës dhe Hajmel është aktualisht i ulët.

Mungesa e mjediseve të parqeve, qendrës urbane, mungesa e shtigjeve dhe shëtitoreve panoramike veçanërisht pranë vijës së ujit, mungesa e trotuareve dhe korsive për biçikleta që mund të lidhin qendrat dhe mungesa e ndriçimit gjatë natës në këto rrugë kufizojnë mundësitë e lëvizjes dhe kalimi i kohës së lirë të turistëve dhe shijimi i potencialit turistik të mjedisit bregdetar që këto dy qendra kanë pranë tyre.

Projektet që kontribuojnë në drejtimet e mësipërme duhen vlerësuar si projekte që shtojnë vlerën e mjediseve urbane si për turizëm dhe për rekreacionin e banorëve.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e urbanistikës në bashkëpunim me zyrën e turizmit duhet të hartojë projekt-fisha për projektet e mësipërme dhe për të kërkuar financim nëpërmjet projekteve tëndryshme.

Nga PKST Alpe :

Projekt 7: Rikualifikim i qendrës së fshatit Koman. Lokalitet i nivelit të II -të

Sipërfaqja: 2000 m²

Vlera e projektit: 150.000 €

3.4.1 Investim në rrugën e Komanit

3.4.2 Ndërtimi i infrastrukturës së ndriçimit, sistemi i shtigjeve dhe vendosja e stolave përgjatë brezit Mjeda-Lac i Vaut në Dejë – Qafa e Gurit dhe Kisha e Shën Mërisë në rrugën Dejë – Digë se Qyrfaqit – Kalaja e Dejës dhe në Koman.

3.4.3 Përmirësimi i rrugëve dhe shtigjeve drejt atraksioneve si Kalaja e Dejës, Sapa, drejt Cukalit.

3.4.4 Zhvillimi i infrastrukturës së kalatave në bashkëpunim me KESH dhe FSHZH

3.4.1 Investimi në rrugën e Komanit

Nga PKST I Alpeve, FSHZH

Titulli i Projektit: Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vau i Dejës – Koman – Liqeni i Komanit

Objektivat: Rritja e aksesibilitetit të limanit të Komanit
Rehabilitimi i rrugëve

Përshkrimi:

Aksi rrugor SH25 Vau i Dejës – Koman – liqeni i Komanit duhet të rikonstruktohet dhe të pajiset me sinjalistikën e posaçme për të përmbushur kriteret e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë për t'u klasifikuar si "rrugë interurbane dytësore".

Kushtet specifike të zbatimit:

Kategoria e rrugës:

Rrugë interurbane dytësore

- ✓ Gjatësia e rrugës = 32,5 km
- ✓ Gjerësia e rrugës = 8 m
- ✓ Rrugë me 2 kalime

Përfituesit: Bashkia Vau i Dejës dhe Bashkia Pukë

Vlera e projektit: SH25 Vau Dejës – Koman – Liqeni i Komanit = 9.100.000 €

Financuesit e mundshëm:

- ✓ Qeveria Qendrore
- ✓ Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- ✓ Donatorë të ndryshëm

3.4.2 Ndertimi i infrastruktures ndricuese, sistem shtigjesh dhe montim stolash pergjate bendit Mjede – Lac i Vaut te Dejes

– Qafa e Gurit dhe Kisha e Shen Merise ne Deje

– rruga e Diges se Qyrsaqit

– Kalaja e Dejes dhe ne Koman.

Integrimi i vijes ujore pergjate bendit Mjede-Lac i Vaut te Dejes – Qafa e Gurit dhe Kisha e Shen Merise ne Deje – rruga e Diges se Qyrsaqit – Kalaja e Dejes si infrastrukture e domosdoshme per aktivitetet rekreative te levizjes ne kembe dhe me bicikleta si per banoret dhe per turistet duke ndertuar infrastrukturen baze – ndricim – sistemim rruge – stola.

Turistet qe qendrojne ne Koman kane mundesi te levizjes dhe shetitjeve gjate oreve te darkes ne nje mjedis te plotesuar me ndricim (plotesimi me Ndricim ne segmentet Vila _franceze -ura dhe pergjate bregut te liqenit drejt njesive administrative dhe kishes) dhe me shtigje shetitjeje pergjate bregut te liqenit.

Pershkrimi i projektit

- ✓ Hartimi i nje projekti per vendosjen e ndricimit per kembesoret ne 3 segmente– pergjate bendit Mjede-Lac i Vaut te Dejes, Lac i Vaut te Dejes, fillimi rruges per te moloja e vincit– Qafa e Gurit, perfshire dhe plazhin e dyte dhe Kisha e Shen Merise– drejtimi i diges se Qyrsaqit– kalaja e Dejes.
- ✓ Per sa i perket segmentit te pare Mjede-Lac I Vaut te Dejes, mund te shikohet dhe studiohet projekti i e vendosjes se ndricuesve ne shtyllat ekzistuese.
- ✓ Perlllogaritet nje projekt qe mund te kete nevojte per vendosjen e 70 shtyllave te ndricimit me nje kosto jo me shume se **70,000 Euro**.
- ✓ Projekti tjeter ka te beje me rregullimin dhe sistemimin e ketyre segmenteve per ecje ne kembe dhe biciklete dhe montim ne pika panoramike te stolave per qendrim.
- ✓ Ky investim eshte investimi me prioritar per nga impakti per shtimin e mundesise se kalimit te kohes se lire per banoret dhe vizitoret ne te tre qendrat e banuara Komna, vau i Dejes dhe Mjede.

- ✓ Plotesimi i funksionimit te Komanit si qender urbane sherbimesh : lehtesimi i ofrimit te sherbimeve baze si dyqan buke, riparim makinash, farmaci, sherbimi mjekesor
- ✓ Korsite per ecje me bicikleta prane qendrave te banuara dhe trotuaret
- ✓ Sistemi I menaxhimit te mbetjeve te ngurta dhe kanalizimeve dhe energjia elektrike dhe furnizmit me uje ne destinacione si ne Koman, zonen perreth dhe gjate brigjeve te bazenit te Vau te Dejes tashme kane nevoje per nje plan dhe programim specifik.
- ✓ Trafiku gjate sezonit drejt tunelit per ne kalaten e liqenit te Komanit menaxhohet ne baze te rregullave te komunikuar me nje sistem tabelash sinjalistike qe orienton qarkullimin, parkimin dhe autorizimin e kalimit te mjeteve qe udhetojne drejt tragetit

3.4.5 Zhvillimi i infrastruktures se molove ne bashkepunim me KESH dhe FSHZH

Sipas planit te KESH per projektet e mundshme te nderhyrjes:

Titulli i Projektit: Teminalet dhe limanet

Objektivat: Nderthurja e menyrove te transportit

Staconimi i linjave te transportit qytetar, nderqytetar dhe turistik

Pershkrimi:

Ndertimi i terminaleve multimodale dhe stacioneve fundore te ndalimit do te mundesoje nderthurjen e menyrove te ndryshme te transportit ne zone e Alpeve Shqiptare. Janë propozuar 2 terminale multimodale, 10 parkime (stacione fundore ndalimi) dhe 9 limane, te cilat do te kenë edhe vende parkimi per automjete private, taksi 4+1, vendqendrim per autobusë dhe zone e ankorimit te tragetit ne rastin e porteve. Keto janë:

1. Limani i grykederdhjes se Shales (per pasagjerë) = 500 m² **100,000 Euro**
2. Limani i Komanit = 1500 m² (Rehabilitim i portit ekzistues dhe zgjerimi i tij) **300,000 Euro**
3. Limani i Komani te Poshtem = 3 000 m² **600,000 Euro**
4. Limani i Shurdhajt = 300 m² **60,000 Euro**
5. Limani i Vaut te Dejes = 3000 m² **600,000 Euro**



- 4.1** *Masat mbështetëse për të lehtësuar, mbështetur, këshilluar dhe gjetur zgjidhje që sipërmarrja e e turizmit të kryhet dhe të konsiderohet brenda kufijve ligjorë*
- 4.2** *Mbështetje për planifikimin e kapaciteteve dhe sipërmarrjet e reja*
- 4.3** *Mbështetje me këshilla dhe informacione për bizneset dhe sipërmarrjet e reja të mundshme për aktivitete, ecje, guidë, akomodim dhe promovim të standardeve*
- 4.4** *Mbështetje me trajnimin e burimeve njerëzore*

4.1 Masat mbështetëse për të lehtësuar, mbështetur, këshilluar dhe gjetur zgjidhje që biznesi turistik të kryhet dhe të konsiderohet brenda kufijve ligjorë

Përgatitja e paketave udhërrëfyese për sipërmarrjen turistike dhe kushtet

Planifikimi i vendeve dhe procedurave për sipërmarrjen turistike

Sqarimi i procedurave të pronësisë dhe lehtësimi i procedurave të lejeve të ndërtimit për objektet turistike

4.2 Mbështetje për planifikimin e kapaciteteve dhe sipërmarrjet e reja

- ✓ Me zbatimin integral të masave të planifikuara në planin e zhvillimit të turizmit, mund të llogaritet se kapaciteti i ofruesve të shërbimeve do të mund të rritet në 5 vitet e ardhshme me rreth 70 biznese dhe aktivitete të lira me një potencial prej rreth 200 punonjësish që në efekti zinxhir i lidhjes së shërbimeve të tjera dhe ofrimi i produkteve ushqimore nga fermat mund të prekë rreth 150 familje apo shërbime të tjera në territor).
- ✓ Shërbime të reja turistike në Temal dhe Shllak (shndërrimi i disa shtëpive/kullave në bujtina, orientimi turistik nga banorët e zonës, rreth 5-10 sipërmarrje të reja)
- ✓ Shërbimet turistike në Koman duhen mbështetur për të përballuar dyfishimin e fluksit të turistëve në 5 vitet e ardhshme, me një kapacitet shtesë akomodues deri në dyfishim dhe me rritjen e ofruesve të shërbimeve turistike mbi 30 sipërmarrje të reja (rritja e kapaciteteve akomoduese me disa bujtina, hotele , kampingjet në zonë, shtimi i disa njësive të shërbimit ushqimor, shtimi i numrit të guidave turistike lokale, shtimi i disa ofruesve të aktiviteteve rekreative ujore, shtimi i disa ofruesve të transportit turistik)
- ✓ Shërbimet turistike në pellgun e liqenit të Vaut të Dejës, minimalisht 20 në total (rritje me disa njësi (min. 5) e shërbimeve turistike për rekreacion në plazh dhe shërbim lokal në zonën bregdetare, rritje me disa njësi (2-3) të oferta e akomodimit me kampingje, shtimi i disa njësive të aktiviteteve rekreative ujore, shtimi i guidave lokale dhe ofruesve të transportit turistik (rreth 10)
- ✓ Shërbimet turistike në zonën Bushat-Hajmel – shtimi i guidave lokale dhe ofruesve të transportit turistik (5-10), shtimi i fermave, njësive agoturiste apo familjeve që presin turistët me traditat e tyre historike dhe tradicionale (min.5).

4.3 Mbështetje me këshilla dhe informacione për bizneset dhe sipërmarrjet e reja të mundshme për aktivitete, ecje, guidë, akomodim dhe promovim të standardeve

Përgjegjësitë dhe burimet:

- ✓ Zyra e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim krijon një paketë informacioni dhe orientimi për sipërmarrjet e reja.
- ✓ Modelet e paketave të tilla mund të zhvillohen sipas modeleve të AIDA-s dhe përvojave edhe pse të kufizuara të bashkive si Shkodra.
- ✓ Këto modele dhe ndërtimi i këtij shërbimi mund të përgatiten në bazë të projekteve për aplikim tek donatorët dhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

4.4 Mbështetje me trajnimin e burimeve njerëzore

Organizimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimeve për një sërë aspektesh si standardet e infrastrukturës për shërbimet e akomodimit, higjiena dhe siguria e ushqimit, koordinimi i informacionit, nevoja për zinxhirin lokal të furnizimit ushqimor, nevoja për trajnime në kuzhinë, trajnimi i stafit të shërbimit, aspekte të konsumatorit, mbrojtjen dhe sigurinë, politikat e çmimeve dhe marketingut, mbrojtjen e mjedisit dhe instrumentet dhe praktikatat përkatëse etj.

Trajnim për guidat lokale

Mbështetja e komunitetit të zonës rurale për iniciativat integruese në shërbimet turistike si bujtina apo ushqimi për njësitë turistike të zonës.

Përgjegjësitë dhe burimet:

Zyra e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit do të duhet të hartojë projekte dhe të jetë e gatshme të bashkëpunojë në zbatimin dhe ofrimin e trajnimeve nga programe të ndryshme zhvillimi dhe trajnimi, përfshirë ato trajnime që ofrohen në rajon në kuadër të projekteve të ndryshme, jo domosdoshmërisht të dizajnuara vetëm për bashki.

5.1 Krijimi i zyrës së informacionit turistik në Koman

5.2 Organizimi i informacionit dhe promovimit me faqet e internetit dhe mediat sociale

5.3 Organizimi dhe promovimi i programit të aktiviteteve dhe panaiereve

5.4 Ndërtimi i një rrjeti informacioni dhe promovimi në pikat e aksesit turistik në destinacionet përreth si Shkodra, Lezha, etj.

- ✓ Nevoja për një zyrë informacioni turistik mund të argumentohet në drejtim të lehtësimit të informacionit për turistët, koordinimit të informacionit për shërbime të ndryshme, informacionit në kohë reale, pikave të kontaktit për feedback , proaktivitetit në rrjetin e informacionit dhe promovimit. Funksionimi i zyrës duhet të mbulojë versionin virtual dhe versionin fizik mund të konsiderohet sezonal dhe pranë destinacioneve kryesore si Komani apo në Vaun e Dejës si në versionin e lëvizshëm kur organizohen aktivitete, panaiere. Zyra e informacionit ka dy

funksiione: atë që konsiderohet si back-office në mbledhjen e informacionit të përditësuar nga subjektet private dhe shtetërore dhe front-office në ofrimin e informacionit të drejtpërdrejtë online ose fizik për klientët. Saktësia dhe përditësimi i informacionit duke ndërtuar një rrjet efektiv komunikimi është i rëndësishëm në funksionin e parë dhe aksesit, disponueshmëria dhe shërbimi ndaj klientit në të dytin.

- ✓ Nevoja për një faqe interneti dhe platformë komunikimi të zyrës së informacionit në rrjetet sociale – pikë referimi për informim dhe promovim, përditësim është i rëndësishëm si dhe postimi i itinerareve në internet në platformën e duhur.
- ✓ Organizimi i materialeve promovuese, veçanërisht hartave turistike, kalendarëve të ngjarjeve, si në versione elektronike ashtu edhe të printuara, të cilat duhet të komunikohen në të gjithë rrjetin e sipërpërmendur, si dhe në panairët turistike në territor apo jashtë tij, kërkon një paketë masash buxhetore për çdo vit për zyrën e turizmit.
- ✓ Nevoja për një rrjet informacioni në pikat hyrëse në territor, si zyra e informacionit turistik në Shkodër, në bizneset e zonës së Shkodrës, Zadrinës, zyra e informacionit në Velipojë, në biznese dhe në komuniteti i agjencive turistike në Tiranë dhe Shkodër
- ✓ Ndërtimi dhe monitorimi i rrjetit të sinjalistikës turistike, inventarizimi dhe përditësimi i tij ndihmon në lehtësimin e informimit dhe orientimit të vizitorëve në rrjet.
- ✓ Ndërtimi i një kalendari vjetor të aktiviteteve turistike në territor, përfshirë panairët, është prioritet si për zhvillimin e produktit turistik, ashtu edhe për marketingun. Këtu duhet të kemi parasysh angazhimet e mundshme të zyrës së turizmit në planifikimin, koordinimin, organizimin, infrastrukturën e eventeve, promovimin dhe pjesëmarrjen me materiale informuese dhe promovuese.

Organizimi i masave dhe ndërhyrjeve në lidhje me destinacionet dhe atraksionet

Prurjet kryesore në territor janë ato të orientuara drejt Komanit.

Prioritet janë ato ndërhyrje që janë identifikuar nga komentet e vizitorëve dhe ofruesve të shërbimeve të renditura në:

1. Masat urgjente për të rregulluar problemet si trafiku në sezon dhe informacioni turistik.
2. Masat për ndërtimin e një sistemi informacioni dhe marketingu për vizitorët dhe aktorët e turizmit: nisja dhe përditësimi i ofertës së gatshme për tregun në platforma të përshtatshme për t'u aksesuar nga tregu dhe krijimi i një rrjeti informacioni, si p.sh. me informacionin turistik të Shkodrës, zyrat, Tiranë, Lezhë dhe agjenci turistike në këto destinacione që transferojnë flukset turistike drejt Vaut të Dejës.
3. Masa që mund të rrisin cilësinë dhe gamën e shërbimeve dhe të rrisin qëndrimin në territor – projekti i ndriçimit që bën të mundur lëvizjen për rekreacion edhe gjatë natës në Koman, Vaun e Dejës dhe Mjedë.
4. Masat bashkëpunuese për zhvillimin e produktit të harmonizuar me marketingun si përmirësimi i aksesit në atraksionet e trashëgimisë kulturore dhe infrastrukturës interpretuese.

Prioritizimi i masave për veprimet e planit kur burimi i financimit për investimet në infrastrukturën paraprahe nuk është i garantuar, do të duhet të ndjekë një sekuençë pune ku masat e buta që lidhen me ngritjen e kapaciteteve dhe organizatave ndihmojnë për mobilizimin e masave që kanë nevojë për ndërhyrje dhe investime infrastrukturore:

- ✓ ngritja e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit
- ✓ ndarjen e buxhetit, duke përfshirë aktivitetet e festave, panairit, informacionin
- ✓ identifikimi i atyre masave për planifikim apo udhëzime planifikimi që kanë penguar zhvillimin e produktit, infrastrukturën turistike
- ✓ zhvillimi i produkteve që varen tek bashkëpunimi i aktorëve, aktivitetet promovuese apo infrastrukturës së lehtë sinjalizuese dhe informative
- ✓ Ndërtimi i proceseve bashkëpunuese dhe koordinuese
- ✓ Aksesit në atraksione duke organizuar një plan vizitueshmërie dhe promovimi i tyre
- ✓ Për investimet, realizimi i të gjithë procesit për krijimin e projekt-fishave të qarta dhe një plani promovues
- ✓ Aspekti rregullues i planit të plazheve, kalatave dhe itinerareve
- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e hapësirës në Qendrën Hajmel për shërbime të përhershme dhe të përkohshme për vizitorët dhe panairin.
- ✓ Ndriçimi për shëtitoren e Qafës së Gurit

Për vitin 2025

- ✓ ndërtimi i kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit duke praktikuar aspekte të bashkëpunimit, menaxhimit të informacionit, koordinimit gjatë sezonit, aspekteve të planifikimit
- ✓ shpërndarja e informacionit dhe koordinimi i informacionit gjatë sezonit
- ✓ organizimi i panairit përgjatë Betlehemit
- ✓ planifikimi i aktivitetet
- ✓ ndarjen e buxhetit, duke përfshirë aktivitetet e pushimeve, panairit, informacionin promovimi i projekteve të investimeve
- ✓ plani i aktivitetet
- ✓ plani investimeve
- ✓ promovim
- ✓ marketingu

4. Buxheti i propozuar per përmirësimin e turizmit në Bashkinë e Vaut të Dejës

4.1Propozime për Ndërhyrje në Projekte Infrastrukturore dhe asistencë teknike për përmirësimin e turizmit
Per Vitet 2025-2030

Drejtimit strategjike	Masat e planit	Buxheti n e lek	Burimi buxhetor
1.Menaxhim i destinacionit turistik në nivel bashkie	1.1 Krijimi i strukturave të ekonomisë dhe turizmit	4,000,000 / vit	Bashkia
	1.2 Ndërtimi i kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit të turizmit duke praktikuar aspektet e bashkëpunimit dhe zbatimin e planit të miratuar të zhvillimit të turizmit.		Bashkia/mbeshtetje nga donatoret
	1.3 Hartimi i projekteve dhe ndarja e buxhetit përfshin ndarjen buxhetore që përfshin aktivitetet e festave, panairove, informacionit		Bashkia
2. Zhvillim i destinacioneve: Koman, Vau i Dejes, Hajmel	2.1 Konsiderimi i Komanit si qendër shërbimesh turistike që ka nevojë si për plan përmirësimi të mjedisit të zones së banuar dhe infrastrukturës		Bashkia/qeveria
	2.2 Projekti i ndriçimit të itinerarit Mjede-Vau i Dejës-Qafa e Gurit për të krijuar mundësinë e lëvizjes gjatë darkës për turistët dhe banorët për shërbime dhe rekreacion.		Bashkia/mbeshtetje nga donatoret
	2.3 Zhvillimi i infrastrukturës së plazheve dhe kalatave në liqenin e Vaut të Dejës		Bashkia/ mbeshtetje nga donatoret/KESH
	2.4 Kompletimi i qendrës së Hajmelit me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime dhe panairove		Bashkia/ financime me FSHZH
3.1 Zhvillimi i infrastrukturës sinjalizuese te produktit turistik	3.1.1. Itineraret e ecjes në natyrë në zonën e Temalit dhe Shllakut plotësojnë standardet bazë me sinjalistikë, me mirëmbajtje periodike të shtigjeve, vendosen në formë dixhitale në inventarin e bashkisë dhe promovohen në faqen e turizmit të bashkisë	2,000,000-3,000,000	Bashkia/ financime me FSHZH/donatore

3.1 Zhvillimi i produktit turistik për zonën Temal dhe Shllak	3.1.2 Në turet e ofruara në Temal dhe Shllak, interpretimi i historisë dhe traditave të zonës dhe vlerave të biodiversitetit pasurohet me interpretimin e guidave lokale, vizitat dhe ofrimin e shërbimeve në shtëpi dhe ferma dhe në ekspozime ose muzetë historikë lokalë.	5,000,000-10,000,000	Bashkia/mbeshtetje nga donatoret
3.2 Zhvillimi i ofertës së itinerareve kulturore-natyrore-historike për zonën e Vaut të Dejës, Bushat-Hajmel	3.1.2.1 Integrimi i burimeve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në ofertën turistike	5,000,000	Bashkia/projekte me donatore
3.3 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve kulturore	3.1.3.3 Ndërtimi i një programi vjetor të aktiviteteve kulturore dhe panaiereve të promovuara gjatë gjithë vitit nga zyra e turizmit	1,000,000 - 2,000,000 /vit	Bashkia/projekte me donatore
3.4 Zhvillimi i ofertës së aktiviteteve rekreative ujore			Bashkia/projekte me donatore
3.5 Zhvillimi i ofertës për turizmin me biçikleta			Bashkia / projekte me donatore
3.6 Zhvillimi i ofertës së turizmit rural të kombinuar me turizmin kulturor për zonën Bushat - Hajmel	3.1.6 Zhvillimi i ofertës së turizmit rural të kombinuar me turizmin kulturor për zonën Bushat - Hajmel	5,000,000-10,000,000	Bashkia / projekte me donatore
4.1 Infrastruktura turistike dhe aktiviteteve	4.1.1 Udhëtimet në Temal dhe Shllak organizohen në bazë të shtigjeve që plotësojnë standardet e udhëzuesve: të kompletuara me sinjalistikë, të transferuara dhe të disponueshme në hartat dixhitale në internet, të mirëmbajtura dhe me guida lokale.	3,000,000-5,000,000	Bashkia/projekte me donatore
	4.1.2 Zhvillimi i infrastrukturës së turizmit kulturor: infrastrukturë për aktivitete dhe panaiere	infrastruktura baze 1,000,000	Bashkia
	4.1.3 zhvillimi i infrastrukturës turistike të itinerareve kulturore-natyrore-historike: sinjalistikë, informacion dhe interpretim	5,000,000-10,000,000	Bashkia/projekte me donatore
	4.1.4 Zhvillimi i infrastrukturës së plazheve	2,000,000	Bashkia

	4.1.5 zhvillimi i infrastrukturës së molove portative	2,000,000	Bashkia/ projekte me KESH/projekte me FSHZH
4.2 Zhvillimi i atraksioneve dhe ambientit turistik	4.2.1 Planifikimi i aktiviteteve turistike në zonat natyrore, përcaktimi i vendeve për veprimtari turistike dhe lejet përkatëse		Bashkia
	4.2.2 Rregulloret për arkitekturën e peizazhit, ndërtesat tradicionale dhe ndërtesat pranë peizazheve natyrore	3,000,000-5,000,000	Bashkia/projekte me donatore
	4.2.3 Planifikimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në atraksione	Buxheti që mund të parashikohet për këto rregullore: 30,000-50,000 Euro	Bashkia/projekte me donatorë
	4.2.4 Masat për mbrojtjen e mjedisit		Bashkia/projekte me donatorë
	4.2.5 Projektet për mjedisin urban Rikualifikim i qendrës së fshatit Koman	15,000,000	Bashkia/KESH/FSHZH
4.3 Zhvillimi infrastruktures ne mbeshtetje te turizmit	4.3.1 Investim në rrugën e Komanit		KESH/qeveria
	4.3.2 Ndertimi i infrastruktures ndricuese, sistem shtigjesh dhe montim stolash pergjate bendit Mjede-Lac i Vaut te Dejes- Qafa e Gurit dhe Kisha e Shen Merise ne Deje-rruga e Diges se Qyrsaqit- Kalaja e Dejes dhe ne Koman.	7,000,000	Bashkia/projekte me donatore
	4.3.3 Përmirësimi i rrugëve dhe shtigjeve drejt atraksioneve si Kalaja e Dejës, Sapa, drejt Cukalit.		Bashkia/FSHZH
	4.3.4 Zhvillimi i infrastrukturës së kalatave në bashkëpunim me KESH dhe FSHZH		Bashkia/KESH/FSHZH
5. Mbeshtetje per zhvillimin e sherbimeve turistike dhe burimeve njerezore	5.1 Masat mbështetëse për të lehtësuar, mbështetur, këshilluar dhe gjetur zgjidhje që sipërmarrja e e turizmit të kryhet dhe të konsiderohet brenda kufijve ligjorë		Bashkia/projekte me donatorë/ projekte me ministrinë e ekonomisë
	5.2 Mbështetje për planifikimin e kapaciteteve dhe sipërmarrjet e reja		Bashkia/projekte me donatorë/ projekte me ministrinë e ekonomisë
	5.3 Mbështetje me këshilla dhe informacione për bizneset dhe sipërmarrjet e reja të mundshme për aktivitete, ecje, guidë, akomodim dhe promovim të standardeve		Bashkia/projekte me donatore/ projekte me ministrine e ekonomise

	5.4 Mbështetje me trajnimin e burimeve njerëzore		Bashkia/projekte me donatorë/ projekte me ministrinë e ekonomisë
6. Marketingu turistik dhe informacioni per vizitoret	6.1 Krijimi i zyrës së informacionit turistik në Koman	1,000,000 / vit	Bashkia/projekte me donatore
	6.2 Organizimi i informacionit dhe promovimit me faqet e internetit dhe mediat sociale		Bashkia/projekte me donatore
	6.3 Organizimi dhe promovimi i programit të aktiviteteve dhe panairove	500,000 / vit	Bashkia/projekte me donatore
	6.4 Ndërtimi i një rrjeti informacioni dhe promovimi në pikat e aksesit turistik në destinacionet përreth si Shkodra, Lezha, etj.		Bashkia ne bashkepunim me bashkite fqinje/ projekte me donatore
TOTALI		89,000,000 LEKE	

4.2 Propozime për Ndërhyrje infrastrukturore në nivel strategjik siaps propozimeve të palëve të treta





No. Propozime bazuar në studime të mëoparshme		Propozimi ne LEKE
1.	Ndërtimi I rrugës Sh25 Vau Dejës-Koman-Liqeni I Komanit	910,000 000
2.	Limani i grykederdhjes së Shalës (për pasagjerë) = 500 m2	10,000,000
3.	Limani i Komanit = 1500 m2 (Rehabilitim i portit ekzistues dhe zgjerimi i tij)	30,000,000
4.	Limani i Komani të Poshtëm = 3 000 m2	60,000,000
5	Limani i Shurdhajt = 300 m2	6,000,000
6.	5. Limani i Vaut të Dejës = 3000 m2	60,000,000
	TOTALI	1,076,000,000 LEKE



TRAJNIME PËR STAFET E BASHKISË

Muaji Shkurt 2024, nisi me trajnimin me disa përfaqësues të stafit të Bashkisë së Vaut të Dejes, mbi hartimin e planit të zhvillimit të turizmit të zonës. Dita e parë e trajnimit u drejtua nga eksperti Z. Luan Dervishej.

U diskutuan disa tema si: pritshmëritë e pjesëmarrësve për objektivat e planit, përfshirja e strukturave të brendshme të bashkisë dhe përfshirja e aktorëve të jashtëm dhe përvoja e deritanishme e bashkisë në hartimin e zbatimin e projekteve të zhvillimit turistik.



13:46

37%



Posts

About

Videos

More




Vau i Dejës - si Destinacion T...









21 May



Në kuadër të hartimit të planit të zhvillimit të turizmit nga eksperti z. Luan Dervishej zhvilluam sot konsultime me stafin e Bashkisë së Vaut të Dejës mbi prioritetet strategjike të zhvillimit të turizmit për 5vjecarin e ardhshëm
#tourism #vauidejes #visitalbania












PROJECT: "VAU DEIES AS TOURISM DESTINATION"
ATTENDANCE SHEET

EVENT: **18-03-2017**
 PLACE: **Municipality of Vau Deies**

NO.	NAME AND SURNAME	ORGANIZATION	E-MAIL	SIGNATURE
1	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
2	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
3	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
4	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
5	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
6	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
7	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
8	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	
9	Guo. Bazon	Ado. Bazon	gabriel.bazon@vau.deies.com	

The Project: "VAU DEIES AS TOURISM DESTINATION"
 Date: 18-03-2017

10	Melinda Klein	Andria Van Dyke	sketches, plans, and photos	
11	Melinda Klein	5 Ann Smith, Ayl D	sketches, plans, and photos	
12	Ed Schuck	504 - Bay St. West	sketches, plans, and photos	
13	Anna Van Dyke	504 - Bay St. West	sketches, plans, and photos	
14	Ed Schuck	504 - Bay St. West	sketches, plans, and photos	
15	Anna Van Dyke	504 - Bay St. West	sketches, plans, and photos	
16	Anna Van Dyke	504 - Bay St. West	sketches, plans, and photos	
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				



GPR
 Ground Penetrating Radar
 Geophysical Services